

PJESA II

MODELE TESTESH

ARSIMI PARASHKOLLOR

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Qarko përgjigjen e saktë. Cili vendos se për çfarë do të përdoren *paratë* që u kërkohen prindërve?
 - A) Bordi i kopshtit.
 - B) Drejtoresha e kopshtit.
 - C) Stafit i mësueseve të kopshtit.
 - D) Mësueset e çdo grupi.

2. Qarko përgjigjen e saktë. Mbi cilin parim bazohen lidhjet midis kopshtit dhe familjes:
 - A) Prindërve u demonstrohen metoda dhe teknika zhvillimi që t'i përdorin në shtëpi.
 - B) Mësueset dëgjojnë prindërit dhe përdorin informacion rreth strategjive pozitive.
 - C) Mësueset dhe prindërit komunikojnë rreth praktikave të mirërritjes së fëmijëve.
 - D) Prindërit janë ndikuesit kryesorë në jetën e fëmijëve të tyre.

3. Shkruaj disa prej të drejtave të fëmijëve të shkruara në Dispozitat normative:
Fëmijët kanë të drejtë:

PËR PROGRAMIN

4. Krahas zbatimit të kërkesave të programeve të parashkollorit, mësuesja monitoron ecurinë dhe progresin e fëmijëve të grupit. Për këtë ajo realizon një vlerësim të fëmijëve brenda tri javëve të para të kopshtit, një vlerësim të dytë në mes të vitit dhe vlerësimin e tretë në fund të tij.
Nisur nga përvoja juaj, çfarë duhet të mbajë parasysh mësuesja për secilin vlerësim?

5. Qarko përgjigjen e saktë. Fëmija i kalon momentet kryesore të zhvillimit të tij në fëmijërinë e hershme:
- A) në të njëjtën kohë me bashkëmoshatarët;
 - B) më herët se bashkëmoshatarët;
 - C) më vonë se gjysma e bashkëmoshatarëve të tij;
 - D) pak më herët ose pak më vonë se bashkëmoshatarët e vet.
6. Plotëso. Në programin e zhvillimit gjuhësor, për fëmijët 5-6 vjeçarë, synohet:
7. Cilës fushë kurrikulare i përket veprimtaria e mëposhtme?
Fëmijët bashkojnë deri në 18-25 figura të pazllës, duke u mbështetur në ngjyrën dhe formën e tyre.
8. Cilës fushë kurrikulare i përket konceptet *rregulla, qëndrime, respekt, kopsht/shkollë, shtëpi dhe sjellje*?

PËR METODIKËN

9. Përcaktimi i veprimtarive për çdo temë javore, ka lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e objektivave të programit. Kur është koha më e përshtatshme që mësuesi t'i mendojë dhe t'i planifikojë këto veprimtari? Argumentoni përgjigjen tuaj.
- A) Në fillim të vitit shkollor së bashku me përcaktimin e temave mujore.
 - B) Para fillimit të zbatimit të temës për çdo muaj.
 - C) Pasi përfundon një temë dhe analizon arritjet përgjatë saj.
 - D) Apo...(Plotëso) _____
Sepse _____
10. Cili do të ishte *mesazhi* që u përcillet fëmijëve të grupit, kur mes tyre ka fëmijë romë, fëmijë me aftësi të kufizuar, fëmijë me probleme të ndryshme familjare?
11. Prerja me gërvshërë është një proces që nis në grupin e dytë. Cilat janë hapat nëpër të cilat do të kalojnë fëmijët për të fituar aftësinë e prerjes me gërvshërë.

12. Fëmijët e grupit të dytë diskutojnë me njëri-tjetrin se pse nuk zhytet varka në ujë. Në qendrën e ujit dhe të rërës ata hedhin në një govatë me ujë dhe materiale të tilla, si: copa dërrase, petëza plastike, letra, gurë, gozhdë, rërë etj. Me çfarë veprimtarie po merren fëmijët në këtë qendër?

- A) Konstruktive
- B) Riproduhuese
- C) Zbuluese
- D) Krijuese

13. Një nga objektivat e linjës “Vetësiguria dhe respekti për veten” është “Të tregojë kujdes dhe shqetësim për veten”. Si duhet të veprojë mësuesi për të realizuar këtë objektiv nga ana metodike?

14. Lidh me shigjetë.

- Pakësimi ka të bëjë me
- Ripërdorimi ka të bëjë me
- Riciklimi ka të bëjë me

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

15. Qarko përgjigjen e saktë.

Cila është dita e Tokës:

- A) 22 marsi
- B) 21 prilli
- C) 22 prilli
- D) 8 maji

16. Cilat janë 4 grupet kryesore të ushqimeve?

17. Plotëso.

Pasi është dhënë gjysma e një figure, ndërtohet gjysma tjetër e barabartë me të parën për të dhënë konceptin e _____.

18. Shkruaj 2-3 njësi matjeje standarde që mësojnë fëmijët parashkollorë.

19. Plotëso.

Nga dallon semafori për kalimtarët nga semafori për qarkullimin e mjeteve në rrugë?

20. Në linjën “Simbolet e qytetarisë” të programit të shkencave sociale, qytetaria përfshin


21. Shpjego eksperimentin.

Mbushim një gotë me ujë. Vëmë mbi të një kartolinë, ana e shkëlqyer e të cilës është nga uji. Duke mbajtur mirë kartolinën me një dorë, kthejmë gotën përmbys me dorën tjetër.

Çfarë ndodh? Pse?

22. Vizato trupin e njeriut duke përdorur trupa gjeometrikë.

23. Emërto fazat nëpër të cilat kalon rritja e fluturës.



24. Në cilin temperaturë uji shndërrohet në akull?

25. Shëno me (V) ose me (G).

E vërtetë (V) E gabuar (G)

Të gjithë shpendët fluturojnë.

Merimanga është insekt.

Sot nuk më dinosaurë.

Në klasën e zvarranikëve hyn vetëm breshka.

Gjitarët i ushqejnë të vegjëlit me qumësht.

Amfibët i çelin vezët në tokë.

Mendohet se dinosaurët janë parardhësit e

zvarranikëve të sotëm.

26. Sistemi ynë diellor ka 9 planetë. Lidh me shigjetë.

Toka Dielli Mërkuri Saturni Plutoni Marsi Venusi Jupiteri Urani	<ul style="list-style-type: none">• Është planeti më afër diellit.• Dallohet për unazat e bukura që ka rreth e qark.• Është planeti ku jetojmë.• Quhet ndryshe edhe Afërdita.• Zakonisht rrotullohet rreth Neptunit.• Quhet ndryshe planeti i kuq.• Është planeti më i nxehtë.• Është planeti i shtatë nga dielli.• Është ylli në qendër të sistemit tonë diellor.
---	--

27. Plotëso.

a) Në cilën prej përrallave, fëmijët marrin mesazhin e kujdesit ndaj njerëzve dhe situatave të të panjohura?

b) Si e përcjell mësuesja këtë mesazh te fëmijët?

28. Vizato një algoritëm me figura gjeometrike duke u mbështetur në dy cilësi të kundërta.

29. Fëmijët njihen me sendet personale që në grupin e parë. Cilat janë 2-3 sende personale të cilat nuk duhet të përdoren nga të tjerët.

30. Plotëso.

- Për të dëgjuar rrahjet e shpeshta të zemrës, fëmijët vihen të
- Për të ndier si zgjerohen mushkëritë, fëmijët
- Për të ndier nevojën e urinimit, fëmijët duhet të

31. Në ç'mënyra mund të përcillet ndërmjet fëmijëve tema "Falim dashuri".

32. Vizato një vijë të hapur, një vijë të lakuar, një vijë të thyer dhe një vijë të mbyllur. Emërto vijat e vizatuara.

ARSIMI 9-VJEÇAR

CIKLI FILLOR

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Qarko përgjigjen e saktë.

Cili vendos se për çfarë do të përdoren *paratë* që u kërkohen prindërve?

- A) Bordi i shkollës.
- B) Drejtori i shkollës.
- C) Këshilli pedagogjik.
- D) Mësuesi kujdestar.

2. Qarko përgjigjen e saktë.

Orët e lira **NUK** mund të përdoren:

- A) për përforcimin e lëndës.
- B) për projekte kurrikulare.
- C) për të plotësuar orët e pazhvilluara nga mësuesi për arsye shëndetësore.
- D) për vlerësime të nxënësve në nivel shkolle.

3. Qarko përgjigjen e saktë.

Udhëzimi "*Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve*" u kërkon mësuesve:

- A) të shkruajnë objektivat e kapitullit në tre nivele.
- B) të shkruajnë objektivat e orës mësimore në tre nivele.
- C) të përqendrohen, në radhë të parë, te niveli minimal i kapitullit.
- D) të përqendrohen, në radhë të parë, te niveli minimal i orës mësimore.

4. Qarko përgjigjen e saktë.

Mësuesi, që është anëtar i bordit të shkollës:

- A) caktohet nga drejtori i shkollës.
- B) zgjidhet me votim nga personeli i shkollës.
- C) zgjidhet me votim nga bordi i shkollës.
- D) caktohet nga kryetari i bordit të shkollës.

PËR PROGRAMIN

5. Plotëso

Parimet për mësimin e lëndës së gjuhës shqipe janë:

- *Parimet e përgjithshme* që nënkuptojnë
- *Parimet shkencore* që nënkuptojnë
- *Parimet didaktike* që nënkuptojnë

6. Përcakto se cilës nënlinjë të linjës “Gjeometria” i përkasin këto objektiva: *Në fund të klasës së katërt, nxënësit të jenë në gjendje:*

- Të dallojnë dhe të emërtojnë figura gjeometrike (katror, drejtëkëndësh, trekëndësh, trapez, paralelogram, rreth) dhe elementet e tyre.
- Të përshkruajnë (duke i parë) vetitë e figurave të thjeshta gjeometrike (katror, drejtëkëndësh, trekëndësh, rreth, trapez, paralelogram).
- Të dallojnë dhe të vizatojnë këndin e drejtë, të ngushtë, të gjerë dhe të shtrirë.
- Të dallojnë, të emërtojnë dhe të vizatojnë drejtëza paralele, drejtëza që priten, drejtëza pingule.

Nënlinja _____

7. Cilës *linje* të programit të edukimit muzikor i përkasin këto objektiva?

- Të krijojë ritme të thjeshta nëpërmjet instrumenteve me goditje.
- Të shoqërojë këngët ose meloditë e ndryshme me instrumente ORF.

Linja _____

8. Plotëso.

Synimi i programit të diturisë së natyrës është sigurimi i arsimimit fillestar në _____ dhe aftësimi i fëmijëve në procesin e fitimit dhe të zhvillimit të koncepteve elementare shkencore.

9. Në lëndën e aftësimit teknologjik, konceptet si: *makineri, materiale, mekanizëm, forcë, pajisje, skicë*, trajtohen në linjën

Linja _____

10. Qarko përgjigjen e saktë.

Konceptet për *simbolet kombëtare* dhe origjinën e tyre, trajtohen në tematikën:

- A) Hyrje në lëndën e historisë.
- B) Fillimet e jetës njerëzore.
- C) Fillimet e jetës njerëzore në vendin tonë. Ndryshimi dhe vazhdimësia.
- D) Shqipëria atdheu ynë.

PËR METODIKËN

11. Qarko përgjigjen e saktë.

Objektivi minimal duhet të arrihet nga:

- A) 25% e nxënësve të klasës.
- B) 50% e nxënësve të klasës.
- C) 75% e nxënësve të klasës.
- D) 100% e nxënësve të klasës.

12. Një mësues duket se zbaton mësimdhënien me nxënësin në qendër kur:

13. Qarko përgjigjen e saktë.

Pyetjet vlerësuese u kërkojnë nxënësve:

- a) të bëjnë analizën e problemeve.
- b) të bëjnë gjykime rreth temës që diskutohet.
- c) të zbulojnë lidhjet mes ideve, fakteve etj.
- d) të riprodhojnë përmendsh informacionin faktik.

14. Lidh foljet me objektivat përkatëse.

15. Nisur nga përvoja juaj, trego se në cilat raste nxënësit i mësojnë më mirë kuptimet e fjalëve të reja.

16. Shkruaj 1 prej shkaqeve të zakonshme kur një nxënës shfaq sjellje të padëshirueshme në klasë dhe 2 strategji që mund të përdoren për qetësimin e situatës.

Sjellja e padëshiruar

Shkaku

Strategjitë e zgjidhjes

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

17. Përdor në fjali fjalën drejt si:

Ndajfolje _____ Parafjalë _____

18. Qarko përgjigjen e saktë.

Te cila prej fjalive të mëposhtme fjala ditë përdoret si kryefjalë?

- A) Sot është një ditë e bukur.
- B) Dita e sotme kaloi shumë bukur në shkollë.
- C) Ditën e sotme s'kam për ta harruar kurrë.
- D) Nga dita e sotme mësova shumë.

19. Qarko përgjigjen e saktë.

Në cilën prej shprehjeve të mëposhtme fjala vesh është përdorur në kuptimin e parë?

- A) iu skuqën veshët
- B) veshi i rrushit
- C) ngriti veshët
- D) nuk çalon gomari nga veshët

20. Qarko përgjigjen e saktë. Në cilën prej alternativave të mëposhtme përdorimi i apostrofit NUK është i saktë?

- A) S'i fola.
- B) M'u sos durimi.
- C) T'i mos fol.
- D) Ç'do këtu?

21. Formo dy mbiemra të prejardhur nga temat:

a) vendim _____ b) shkolla _____

22. Ligjëratën e zhdrejtë ktheje në ligjëratë të drejtë.

Mësuesi thoshte gjithmonë se Adela kishte talent të veçantë në pikturë.

23. Në fjalinë “Artani luan në lulishte.”, zgjero grupin emëror me një mbiemër dhe grupin foljor me një rrethanasor kohe.

24. Në fjalinë “Një copë herë, ai qeshi ngadalë dhe më përkëdheli flokët e shpupurisur.” gjej trajtën e shkurtër. Përcakto numrin dhe rasën e saj.

• trajta e shkurtër _____ • rasa _____ • numri _____

25. Plotëso. Përcaktori mund të jetë (të shprehet):

26. a) Shpjego kuptimin e fjalës “kundroj”.

b) Gjej një fjalë të re që ka të njëjtin kuptim me të.

27. Trego mënyrën e ndërtimit të fjalive të mëposhtme.

a) Jori merr rregullisht libra në bibliotekë.

b) Deti ishte i qetë.

c) Lexoj rrjedhshëm.

28. Nëse 60% e një numri është 78, cili është ky numër?

A) 120

B) 130

C) 140

D) 150

29. Igli udhëton 42.84 km me makinë dhe 1350 m në këmbë në ditë.

Sa kilometra bën ai gjithsej në ditë? _____

Sa metra bën ai gjithsej në ditë? _____

30. Qarko përgjigjen e saktë.

Rrumbullakimi i numrit 3748 me afërsi deri në qindëshe është:

A) 3700

B) 3750

C) 3800

D) 4000

31. Është dhënë thyesa . Shkruaj 2 thyesa të barabarta me thyesën e dhënë.

32. $e x = y$. Gjej vlerën e x, në qoftë se $y \{ 21, 24, 42, 75 \}$

33. Shuma e dy numrave është 70. Njëri numër është e numrit tjetër.

Gjej të dy numrat. Numrat janë _____ dhe _____.

34. Gjej vlerën e shprehjes $46, 7 - (b - 0,8) + 2,7$ për $b = 1,2$

35. Qarko përgjigjen e saktë. Mbreti i parë ilir ishte:

- A) Bardhyli
- B) Genti
- C) Batoja
- D) Agroni

36. Qarko alternativën që **NUK** është e saktë.

- A) Parahistoria është historia e njerëzimit pas shpikjes së shkrimit.
- B) Në periudhën e parahistorisë njeriu mësoi të bëjë vegla pune.
- C) Në periudhën e parahistorisë njeriu u ngrit më këmbë.
- D) Në parahistori njerëzit filluan të komunikojnë me njëri-tjetrin me anën e gjuhës.

37. Plotëso fjalinë.

Megjithë ndikimet nga popujt e tjerë, ilirët ruajtën _____, _____, _____ e tyre.

38. Qarko përgjigjen e saktë.

Nëse shohim myshk në pyll do të thotë se jemi drejtuar nga:

- A) jugu.
- B) lindja.
- C) veriu.
- D) perëndimi.

39. Qarko përgjigjen e saktë.

NUK është pikë orientuese për të gjithë banorët e Tiranës:

- A) sheshi “Skënderbej,,
- B) Qendra kulturore e fëmijëve “Pjetër Arbërori,,
- C) Universiteti i Tiranës.
- D) sheshi para pallatit tim.

40. Qarko përgjigjen e saktë. Shtypja atmosferike është:

- A) gjatësia e ajrit.
- B) pesha e masës së ajrit.
- C) temperatura e masës së ajrit.
- D) të gjitha të mësipërmet.

41. Plotëso.

Pentagrami është bashkësia e _____.

42. Shëno me (✓) pohimet e sakta.

- Ngjyrat bazë janë: e kuqe, e verdhë, blu.
- Ngjyrat bazë janë: e kuqe, jeshile, e verdhë.
- Ngjyrat e dyta janë: portokalli, jeshile, lejla
- Ngjyrat e dyta janë portokalli, blu, rozë.
- Ngjyrat bazë krijohen nga përzierja e ngjyrave të tjera.
- Ngjyrat e dyta krijohen nga përzierja e dy ngjyrave bazë.

43. Në kuadrin e zhvillimit të temave që kanë lidhje me edukimin mjedisor, shkruaj se ***cilat veprimtari*** do të organizoje me nxënësit e klasës për 22 prillin, Ditën e Tokës dhe ***pse***.

44. Qarko përgjigjen e saktë.

Cila nga alternativat e mëposhtme është ligj?

- A) Ardhja në shkollë në orën 7³⁰.
- B) Arsimi 9-vjeçar është i detyruar për të gjithë.
- C) Veshja e nxënësve me uniformën shkollore.
- D) Vendosja e orarit të mësimin në një pozicion të dukshëm.

45. Gjej fjalën e duhur.

_____ është aftësia që ka individi për të kontrolluar sjelljet dhe veprimet e tij.

_____ është një grup njerëzish që jetojnë në të njëjtin vend dhe kanë interesa të përbashkëta.

46. Plotëso.

a) Emigrimi është _____

b) Migrimi është _____

GJUHË SHQIPE

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Si veprohet me një nxënës, i cili ka munguar në 40% të numrit të orëve?
2. Nxënësi duhet të njihet me vlerësimin e testit nga mësuesi i lëndës brenda:
 - A) 5 ditëve
 - B) 7 ditëve
 - C) 10 ditëve
 - D) 12 ditëve
3. Nëse një nxënës nuk është i kënaqur me vlerësimin e bërë nga mësuesi i lëndës, cilat janë rrugët që duhet të ndjekë ai?

PËR PROGRAMIN

4. Në përbërje të bordit të shkollës bën pjesë:
 - A) vetëm një mësues.
 - B) të paktën një mësues.
 - C) një nëndrejtor i shkollës.
 - D) drejtori dhe nëndrejtori i shkollës.
5. Çfarë përfshijnë standardet e nxënies?
6. Një nga parimet ku mbështetet programi i gjuhës shqipe është *parimi koncentrik*. Çfarë nënkupton ky parim?
7. Identifikoni dy arsye pse mësuesi i përdor $1/3$ e orëve të lira.

PËR METODIKËN

8. Minitesti në lëndën e letërsisë dhe gjuhës shqipe kontrollon:
- A) objektivat e kapitullit ose linjës lëndore.
 - B) një objektiv të orës ose të kapitullit/linjës.
 - C) të gjithë objektivat e një ore mësimi.
 - D) të gjithë objektivat e programit mësimor.
9. Rendisni tri metoda të mësimdhënies në klasë që realizojnë të nxënit bashkëveprues.
10. Cilat janë veçoritë e mësuesit si mësimdhënës? Shkruani dy prej tyre.
11. Në rubrikën të lexojmë, për temën: “ *Poradeci*”, hartoni nga një objektiv të arritjes sipas tri niveleve:
- a) niveli bazë:
 - b) niveli i mesëm:
 - c) niveli i lartë:
12. Nëse hartoni një test që ka 30 pikë, me sa pikë të fituara do ta vlerësoni nxënësin me notën:
- a) 5 (pesë): _____ b) 8 (tetë) _____

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

Lexoni poezinë e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

PORADECI

Perëndim i vagëlluar mbi Liqerin pa kufir.
Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije.
Nëpër Mal e nër Lëndina shkrumb’ i natës që po bije,
Dyke zbritur që nga qjelli përmbi fshat po bëhet fir...

E kudo krahin’ e gjerë më s’po qit as pipëlim:
Në Katund kërcet një portë...në Liqer heshtë një lopatë...
Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t’im.

Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...

Zotëroj më katër anë errësira... Po tashi:

Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,
Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi.

13. Ideja e lëvizjes dhe jetës që s'vdes kurrë, në këtë poezi konkretizohet në imazhin që krijon:

- A) lumi në udhëtimin e tij të pandërprerë.
- B) liqeni i përmasave pa kufi.
- C) madhështia maleve dhe lëndinave.
- D) zemra djaloshare por e trazuar e poetit.

14. Cili nga çiftet e mëposhtme krijon antonimi të kontekstit poetik?

- A) plak – i përrallshëm
- B) natë – errësirë
- C) ra – u dergj
- D) hesht - kërcet

15. *Perëndim i vagëlluar* ka kuptimin.

- A) perëndim i ndritur
- B) perëndim i qetë
- C) perëndim i kuq
- D) perëndim i mjegullt

16. Në cilin prej vargjeve është pikërisht grupi i foljeve që, përmes një shkallëzimi zbritës, jep idenë e qetësisë?

- A) Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
- B) Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...
- C) E kudo krahinë' e gjerë më s'po qit as pipëlim:
- D) Në Katund kërcet një portë...në Liqer heshtë një lopatë...

17. Cili nga vargjet e mëposhtëm ka një rend të përmbysur sintaksor?

- A) Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...
- B) Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi.
- C) Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
- D) Njëpër Mal e nër Lëndina shkrumb' i natës që po bije

- 18.** Përshkruani atmosferën që sugjeron kjo poezi në dy strofat e saj të para?
- 19.** Me ç'pjesë të ligjëratis janë formuar metaforat e mëposhtme?
a) shkumb i natës: _____
b) jeta u dergj: _____
- 20.** Ç'përfytyrim krijon aliteracioni dhe reticenca në vargjet e mëposhtme?
*Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...
Zotëroj më katër anë errësira...*
- 21.** Fjala *errësira*, në këto vargje mund të interpretohet në dy mënyra:
të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm. Si e kuptoni secilën prej tyre?
- 22.** a) Dy vargjet e fundit hyjnë në kontrast me pjesën tjetër të poezisë.
Cili është thelbi i tij dhe si do ta interpretonit këtë kundërvënie?
b) Me çfarë lidhet shqetësimi dhe dhimbja e poetit në këto vargje?
- 23.** Cilës pjesë të ligjëratis i përket fjala *i përrallshëm*? Si është formuar ajo? Zbuloni efektin e shprehësisë që krijon kjo fjalë.
a) pjesa e ligjëratis: _____ b) formimi: _____ c) efekti i shprehësisë: _____
- 24.** Disa emërtime të përgjithshme vendore poeti i shkruan me shkronjë të madhe. Gjeni të paktën dy prej tyre dhe tregoni arsyen e një përdorimi të tillë.
- 25.** Analizoni fjalën *përskuqte* sipas ndërtimit.
- 26.** Ndërtoni një fushë (konceptore) leksikore terminologjike, me jo më pak se tri njësi, që të lidhet me termin *fjali*.
- 27.** Në fjalinë: *Në dritare erdhi prej pyllit flladi i freskët*, parafjala *prej* tregon:
A) vend
B) shkak
C) vepruesin
D) tërësinë

- 28.** Vendosni foljen *ndjej* në mënyrën dëshirore, koha e tashme, veta 3, numri shumës.
- 29.** Vendosni foljen *flas*, në mënyrën urdhërore, numri shumës.
- 30.** Përcaktoni klasën e fjalëve me shkronja të zeza:
- a) E la në **vend** të sigurt. _____
- b) **Në vend** të nënës, vajti e bija. _____
- 31.** Qarkoni variantin në të cilin kuptimin e shkallës sipërore e bart tema fjalëformuese.
- A) Qielli ishte më i zymtë se dje.
- B) Kjo tokë e stërlashtë ka histori të lavdishme.
- C) Ajo ishte sa e shkathët, aq edhe gazmore.
- D) Më dukej vetja i vlerësuar nga shokët.
- 32.** Në fjalinë e mëposhtme tregoni funksionin dhe me se është shprehur pjesa e nënvizuar.
- E tërë salla gumëzhinte nga ajo zhurmë e fortë hareje.*
- a) Funksioni: _____
- b) Shprehur me: _____
- 33.** Përcaktoni llojin e fjalive njëkryegjymtyrëshe foljore.
- a) *Rrini së bashku.* _____
- b) *Këtu i thonë Shqipëri.* _____
- 34.** Rishkruajeni fjalinë duke e zgjeruar me një rrethanor të veçuar, të shprehur me emër me parafjalë.
- Te gryka e shpellës u duk portreti i burrit të moshuar.*
- 35.** Zgjeroni fjalinë e dhënë me pjesë të nënrenditur krahasore-mënyrore.
- E pritëm me të gjitha nderimet....*
- 36.** Gjeni funksionin që kryen pjesa e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme.
- Shteg për të shpëtuar nuk kishte.*

- 37.** Ktheni ligjëratën e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë.
Ju i dashur mësues, na thoshit shpesh: “Unë jam i sigurt se ju nuk do t’i harroni kurrë këshillat e mia”.
- 38.** Përcaktoni llojin e fjalive sipas kumtimit.
a) *E po, të rrojmë në një qytet e të mos shihemi!*
b) *Edhe Besmiri fitoi në konkurs?!*
- 39.** Qarkoni fjalinë ku janë përdorur drejt shenjat e pikësimit:
A) Njerëzit thirrën të kënaqur: “Kjo është drejtësi”.
B) Njerëzit thirrën të kënaqur: “-Kjo është drejtësi!”
C) Njerëzit thirrën të kënaqur: “-Kjo është drejtësi.”
D) Njerëzit thirrën të kënaqur: “Kjo është drejtësi!”
- 40.** Qarkoni fjalinë me fjalën e shkruar gabim.
A) Cili nga ju do të shkojë për ta kërkuar?
B) Vapën e madhe e ndjejnë të gjithë.
C) Gëzimi e kishte shndërruar në tjetër njeri.
D) Rrebeshi kishte shkatërruar gjithçka.
- 41.** Shkruani dy elemente që e bëjnë paragrafin njësi tekstore.
- 42.** Ç’është kohezioni?
- 43.** Ç’është koherenca?
- 44.** Cila është gjëja më e rëndësishme për brezin tuaj të cilën do të donit ta dinte brezi më i ri? Pse mendoni se është kaq e rëndësishme? Shpjegoni arsyet tuaja në formën e një eseje.

MATEMATIKË

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Cili pohim është i saktë?
 - A) Kontributi i prindit në lekë është vullnetar.
 - B) Secila familje duhet të japë një sasi lekësh.
 - C) Secila familje duhet të japë 1000 lekë.
 - D) Secila familje duhet të japë nga 1000 lekë për çdo fëmijë që ka në atë shkollë

2. Cili pohim është i pasaktë?
 - A) Bordi i shkollës ka të drejtë të japë mendim për planin vjetor të shkollës.
 - B) Bordi i shkollës ka të drejtë të japë mendim për rregulloren e shkollës.
 - C) Bordi i shkollës ka të drejtë të japë mendim për vlerësimin e nxënësve të veçantë nga mësuesi.
 - D) Bordi i shkollës ka të drejtë të japë mendim për planin katërvjeçar të shkollës.

3. Tek Udhëzimi “Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve” kërkohet që minitestet të zhvillohet:
 - A) nga mësuesi për orën mësimore.
 - B) nga mësuesi për objektivat e kapitullit.
 - C) nga drejtori për orën mësimore.
 - D) nga drejtori për objektivat e kapitullit.

4. Cili NUK nuk bën pjesë në formatin e planit vjetor të shkollës?
 - A) Analiza e gjendjes.
 - B) Detyrat e drejtorit të shkollës për mësuesit.
 - C) Synimi vjetor i shkollës.
 - D) Objektivi vjetor i shkollës.

PËR PROGRAMIN

5. Në programet e matematikës një rubrikë është integrimi.
Përmendni një shembull ku është integruar lënda e matematikës në vitin që ju jepni mësim.
6. Nga programi i matematikës i klasës së nëntë është marrë objektivi:
“Nxënësi të jetë i aftë të zgjidhë sisteme ekuacionesh të fuqisë së parë me dy ndryshore”.
Bazuar në këtë objektiv përcaktoni tri objektiva specifike: një për nivelin bazë, një për nivelin mesatar dhe një për nivelin e lartë.
7. Thelbi i referencave aktuale të kursit të matematikës është zhvendosja e theksit nga dhënia e informacionit te _____
A) marrja e informacionit
B) formimi i kompetencave
C) aftësia për ta mbajtur mend
D) aftësia për ta riprodhuar
8. Më poshtë përmenden disa nga synimet e programit të matematikës.
Gjeni cili nga pohimet nuk është i tillë. Programi i matematikës synon:
A) Të përforcojë, thellojë dhe zgjerojë njohuritë e marra në vitet e mëparshme të shkollimit, në përputhje me potencialin intelektual të grup moshës përkatëse.
B) Të aftësojë nxënësin për punë të pavarur në situata jo standarde, nëpërmjet përfshirjes së tij në marrjen dhe përpunimin e informacionit të ri mësimor, në zbatimin e metodave e algoritmeve, duke trajtuar situata të ndryshme të zbatimit të tyre;
C) Të forcojë karakterin logjik të të nxënit, nëpërmjet një raporti të përcaktuar, drejt rritjes graduale të peshës specifike të trajtimeve deduktive në raport me ato induktive.
D) Të aftësojë nxënësin për përdorimin e pajisjeve mekanike e teknologjike.

9. Gjeni cili nga objektivat nuk i përket linjës “Gjeometria në plan”.
- A) Të njohin vetitë e katërkëndshave (paralelogram, drejtkëndësh, romb, katror, trapez);
 - B) Të njohin vetitë e segmenteve të përpjesëshëm.
 - C) Të njohin e përdorin ngjajshmërinë e trekëndëshave dhe shumkëndshave për të zgjidhur probleme nga jeta e përditshme.
 - D) Të zgjidhin inekuacione të fuqisë së parë me një ndryshore.

PËR METODIKËN

10. Fjala e mësuesit, saktësia, stili i punës, parimësia, mënyra e parashtrimit të çështjeve, ngritjes së problemeve dhe zgjidhjes së tyre, mënyra e argumentimit dhe nxjerrjes së përfundimeve janë mjete të fuqishme për formimin matematik të nxënësve. Në këtë kuptim nxënësi:
- A) është adoleshent
 - B) është pasqyrë e mësuesit të tij
 - C) është minimalisht i informuar
 - D) është i vetdijshëm për të ardhmen
11. Përshkruani si duhet të veprojë mësuesi që nxënësi të ndihet sa më i motivuar në mësimin e matematikës
12. Më poshtë është cituar një pjesë për metodologjinë e zbatimit të programit të matematikës. Gjeni cila nga fjalët e dhëna plotëson pjesën e cituar.
- A) Puna e pavarur
 - B) Eksperimenti
 - C) Ilustrimi
 - D) Administrimi
- “ _____ është një komponent tepër i rëndësishëm i mësimit të matematikës, në mënyrë që të realizohen synimet e programit. Kjo realizohet në orën e mësimit si një proces për të kuptuar përmbajtjen e temës dhe për të aftësuar nxënësit në këtë drejtim nëpërmjet kërkesave për llogaritje, për zgjidhje ushtrimesh të thjeshta, me gojë e me shkrim, për deduksione e interpretime, sugjerime e diskutime, në mënyrë që nxënësi, në orën e mësimit të mos jetë thjesht e vetëm dëgjues. Për çdo temë ka mësim të

veçanta për ushtrime, probleme e detyra praktike. Orët e caktuara për to, shpërndahen nga mësuesi gjatë temave të programit apo zhvillohen në fund të tyre”.

13. Në zbulimin e mjaft fakteve matematike ndihmon shpesh *intuita*.

Intuita është:

- A) ngjashmëri ndërmjet fakteve.
- B) konkluzion i një përvoje të përsëritur në numër të madh herësh.
- C) gjuha që duhet bërë e kuptueshme për nxënësit.
- D) përshkrim, shpjegim, diskutim matematikor.

14. Me poshtë janë disa pohime për metodologjinë e zbatimit të programit të matematikës.

Qarko V, nëse pohimi është i vërtetë, ose G nëse ai është i gabuar.

- A) Studimi i matematikës në arsimin e detyruar kërkon që tek disa nxënës të formohen kompetencat bazë për zgjidhjen e problemeve të matematikës.
- B) Puna e pavarur jashtë klase realizohet nëpërmjet detyrave të shtëpisë me ushtrime e probleme, që zgjidhen me gojë apo me shkrim.
- C) Në realizimin e programit të matematikës, mësuesi ka parasysh klasën në përgjithësi dhe çdo nxënës në veçanti.
- D) Fjala e mësuesit, saktësia, stili i punës, parimësia, mënyra e parashtrimit të çështjeve, ngritjessë problemeve dhe zgjidhjes së tyre, mënyra e argumentimit dhe nxjerrjes së përfundimeve janë mjete të fuqishme për formimin matematik të nxënësve.
- E) Përqendrimi i vëmendjes tek konceptet e aftësitë matematike kërkon zbatime të nivelit të lartë të vështirësisë të tyre, si një fazë e parë e procesit të njohjes së nxënësve me to.

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

15. Gjeni cila nga shprehjet tregon se x është 3,4 herë më i madh se y .

- A) $x = 3,4y$
- B) $y = 3,4x$
- C) $x > 3,4y$
- D) $y > 3,4x$

16. $0,0002 \cdot 10^4 =$

- A) 2
- B) 20
- C) 200
- D) 2000

17. $2^2 + 2^2 + 2^2 + 2^2 =$

- A) 2^1
- B) 2^2
- C) 2^3
- D) 2^4

18. Gjeni cili nga numrat më poshtë është vlera e shprehjes $1 + 2 \cdot \left(1 - \frac{1}{2}\right)$. 0

- A) 1
- B) $\frac{1}{2}$
- C) 2

19. Gjeni vlerën e shprehjes numerike $(\sqrt{3} + \sqrt{3})^2$.

- A) 3
- B) 9
- C) 12
- D) 18

20. Gjeni sa përqind është numri 0,23.

- A) 0,23%
- B) 2,3%
- C) 23%
- D) 230%

21. Trajta e rregullt e shprehjes $2x + 2y + 6x$ është:


- A) $8y + 2x$
- B) $10xy$
- C) $8x + 2y$
- D) $4y + 6x$

22. Grafiku i funksionit $y = 3x - 6$ e pret boshtin OX në pikën me abshisë:
A) $x = -6$
B) $x = 3$
C) $x = 2$
D) $x = 0$
23. Vlera e shprehjes $\frac{2x^2 - 3}{x - 1}$ për $x = 2$ është:
A) 1
B) 5
C) 6
D) 8
24. Zgjedhim rastësisht një numër natyror nga 1 deri në 50.
Gjeni probabilitetin që numri i zgjedhur të jete shumëfish i numrit 5,
por jo shumëfish i numrit 3.
A) 10%
B) 14%
C) 16%
D) 18%
25. Nga bashkësia $\{-9, -8, -3, 0, 7, 10\}$ zgjidhen tre numra të ndryshëm
A, B dhe C. Gjeni vlerën më të madhe të mundshme të $A \times B - C$.
26. Jepen $A =]-1, 1[$ dhe $B = \{-1, 0, 1\}$.
a) Gjeni $A \cup B$.
b) Gjeni numrin e elementëve të $A \cap B$.
27. Thjeshtoni shprehjen $2\sqrt{18} - 4\sqrt{50}$.
28. Krahaso $\frac{a-b}{a+b}$ dhe $\frac{a^2-b^2}{a^2+b^2}$.
29. Gjeni vlerën pozitive më të vogël të x të tillë që $y = \sin 2x$ të marrë vlerën
më të madhe.

- 30.** Trekëndëshi ABC i ka brinjët me gjatësi 2cm, 3cm dhe 4cm. Një trekëndësh tjetër i ngjajshëm me të e ka brinjën më të madhe 6 cm. Gjeni raportin e perimetrave të dy trekëndëshave.
- 31.** Andi dhe Samiu janë dy punonjës në të njëjtën fabrikë. Andi e ka pagën ditore 300 lekë më shumë se Samiu. Shuma e trefshit të pagës ditore të Andit me katërfishin e pagës ditore të Samiut janë 6500 lekë. Gjeni pagën ditore të Andit.

32. Të thjeshtohet shprehja $\frac{x^2 + 2xy + y^2}{xy^2 - x^3}$.

- 33.** Syprina e figurës së dhënë është 108 m^2 . Gjeni vlerën e x.



- 34.** Mesatarja e 10 numrave të dhënë është 46. Gjeni sa është mesatarja e numrave që mbeten, në qoftë se heqim numrat 52 dhe 72.
- 35.** Nëse 1200 metra i përshkoni në 12 minuta, gjeni shpejtësinë tuaj në kilometër për orë.
- 36.** Jepet inekuacioni $4\left(x - \frac{1}{2}\right) < 2(x - 2)$
- Zgjidhni inekuacionin.
 - Paraqitni bashkësinë e zgjidhjeve të tij në boshtin numerik.

37. Zgjidhni sistemin e ekuacioneve
$$\begin{cases} -2x - 2y = 3 \\ x + 2y = 6 \end{cases}$$

- 38.** Jepet funksioni $y = x^2 + ax + 3$:

- Gjeni vlerën e a që grafiku të kalojë nëpër pikën $M(1;6)$.
Për ç'vlerë të x funksioni merr vlerën më të vogël (për vlerën e gjetur a)?

GJUHË ANGLEZE

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Kur një projekt kurrikular ka nevojë për shpenzime financiare:
 - A) mësuesi u kërkon lekë prindërve.
 - B) shkolla përdor nga fondi i kontributit vullnetar të prindërve.
 - C) drejtori u kërkon lekë prindërve.
 - D) kryetari i bordit të shkollës u kërkon lekë prindërve.

2. Ministesti dallohet nga testi sepse:
 - A) zhvillohet për një kohë të shkurtër.
 - B) zhvillohet jashtë orës mësimore.
 - C) zhvillohet vetëm me nxënësit me nota të ulta.
 - D) kontrollon pak orë mësimore.

3. Cila nga pikat e listuara me poshte nuk përfshihet në formatin e planit vjetor të shkollës?
 - A) Analiza e gjendjes.
 - B) Detyrat e drejtorit të shkollës për mësuesit.
 - C) Synimi vjetor i shkollës.
 - D) Objektivi vjetor i shkollës.

4. Udhëzimi “Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve” bën fjalë për:
 - A) objektivat e ciklit të lartë arsimit bazë.
 - B) objektivat vjetore të lëndës.
 - C) objektivat e kapitullit.
 - D) objektivat e orës mësimore.

PËR PROGRAMIN

5. Në cilin nivel gjuhësor parashikohet të arrijë nxënësi në fund të klasës së 9-të, sipas niveleve të përcaktuara në kuadrin e referencave për gjuhët.?

6. Çfarë kuptojmë me:
- objektiva minimalë?
 - objektiva maksimalë?
7. Si ndahen objektivat sipas standardit në mësimdhënien e gjuhës angleze?
8. Në parimet e mëposhtme, mbi të cilat mbështetet mësimi i gjuhës së huaj përmes kurrikulave kombëtare, *gjej parimin e gabuar*.
- Qëllimi
 - Objektivi
 - Aftësi gjuhësore
 - Përmbajtja
 - Tematika
 - Vlerësimi
 - Analiza
 - Standardet

PËR METODIKËN

9. Çfarë duhet të ketë parasysh mësuesi gjatë përgatitjes së tij për hartimin e pyetjeve drejtuar nxënësve?
10. Listoni tre mjete pedagogjike që përdorni në mësimdhënien e gjuhës angleze në klasën e tretë?
11. Jepni dy arsye përse duhet punuar me grupe në mësimin e gjuhës së huaj:
12. Përse shërben “Brainstorm”? Jepni dy arsye

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

13. Reading Comprehension
My name is Margaret, but some people (_1_) me Maggie. I was born in Sacramento, California, but I haven't (_2_) lived there. Midway (_3_) the 6th grade, my family decided to move to Miami. After (_4_) High school, I

went to Junior College for two years before I could transfer to the university. I majored (_5_) Languages. I learned to speak Spanish and German. I also studied French in high school and two years in Junior College. I worked at a French bank (_6_) two years. It was quite enjoyable. However, I couldn't get (_7_) in life without a Master degree, so I decided to go back to school to get a Master in Applied Linguistics. When I finished my course, I moved back to California, and found a job (_8_) a school principal. Nowadays my dream is to (_9_) for a doctorate program in Educational Technology as I'm fascinated (_10_) computers and technology.

Choose the correct words to go into the blanks.

a. finishing b. by c. call d. for e. through f. always g. as h. in i. apply j. ahead

- | | |
|----------|-----------|
| 1. _____ | 6. _____ |
| 2. _____ | 7. _____ |
| 3. _____ | 8. _____ |
| 4. _____ | 9. _____ |
| 5. _____ | 10. _____ |

• Complete the sentences by choosing the phrase that would follow the word or words. (ex. 14 through 16)

14. Glimpses into the prenatal world via ultrasound imaging occasionally show behavior such as:

- A) the development of the central nervous system.
- B) the sex of the baby – to – be.
- C) a fetus sucking the thumb.
- D) structures as small as the pupil of an eye of a second – trimester fetus.

15. Although the animals and plants that live in the world's various deserts come from different ancestral stocks,

- A) they have solved their problems of survival differently.
- B) none of them have adapted to the jungles.
- C) they are from different deserts.
- D) they resemble one another to a surprising degree.

- 16.** Children dress up in witches' hats or goblin suits to play pranks when celebrating the ancient pagan holiday of Halloween. In contrast,
- A) Thanksgiving is a traditional holiday.
 - B) Thanksgiving is always celebrated on the fourth Thursday of November.
 - C) families dress more formally and set elegant tables for the more serious occasion of Thanksgiving.
 - D) children enjoy Thanksgiving.

• For questions 17-26, complete the second sentence so that it has a similar meaning to the first sentence, using the word given. Do not change the word given. You must use between two and five words, including the word given. There is an example at the beginning

Example: - My brother is too young to drive a car.
not
My brother .. is not old enough to... drive a car.

- 17.** Why are you interested in taking up a new hobby?

want

Why up a new hobby?

- 18.** 'Have you seen my gloves anywhere, Eric?' asked Mrs Noble.

seen

Mrs Noble asked Eric her gloves
anywhere.

- 19.** Suzanne was too excited to sleep.

that

Suzanne was not sleep.

- 20.** Robert has not had a job for two years.

out

Robert has for two years....

- 21.** 'I will complete the work only if you pay me £500 extra,' said Frank.

Not

'I will you pay me £500 extra,' said
Frank.

22. The thief ran right past you so I'm sure you saw his face.

must

The thief ran right past you so his face.

23. The clients demanded to stay in a first-class hotel.

staying

The clients in a first-class hotel.

24. I don't object to the council building a new road here.

objection

I the council building a new road here.

25. The author wrote her latest novel while she was staying in Majorca.

was

The author's latest novel stay in Majorca.

26. The newspaper offered Lynda £5,000 for her story, but she refused.

turned

Lynda of £5,000 from the newspaper for her story.

• Circle the correct answer:

27. If I Mary last night, I her to bring my c.d. today.

A) saw / would remind

B) was seeing / could have reminded

C) had seen / would have reminded

D) were to see / would be reminding

(Conditional 2)

28. Should I not pay for my electricity bill tomorrow, they my energy any time.

A) were cutting

B) will have cut

C) would cut

D) may cut

(Conditional 2)

29. As they have had many lessons, Medya and Pervin Italian without a problem.

- A) might have spoken
- B) have had to speak
- C) can speak
- D) would be speaking (Modal verbs)

30. It is defined in the constitution that all citizens their taxes.

- A) have had to pay
- B) should be paid
- C) have to pay
- D) must be paying (Modal verbs)

31. There is a warning the bottom of the form that applicants are requested to hand their forms person.

- A) on / for / at
- B) at / in / by
- C) below / in / for
- D) at / in / in (prepositional phrases)

32. It was that Michael was going to be excluded from team as he hadn't attended any exercise at all.

- A) at hand
- B) beyond doubt
- C) under observation
- D) in fashion (prepositional phrases)

33. The government action into increasing taxes as soon as they by the IMF authorities.

- A) takes /will be urged
- B) took / had been urged
- C) is taking / have been urged
- D) will take / have urged (Verb Tenses)

34. Don't you think it time we typing the report.

- A) is / started
- B) has been / have started

- C) will be / are starting
D) would be / had started (Verb Tenses)

35. the high decrease in inflation, our currency seems to have increased in value.

- A) What's more
B) As far as
C) Thanks to
D) However (Conjunctions)

36. Ned is in the habit of revising just once Tom never understands a subject he revises it for at least three times.

- A) whereas / unless
B) although / thus
C) but / in case
D) besides / or (Conjunctions)

37. Mr. Smith recently incorrect information to tax agents prior to his promotion.

- A) was sued / having supplied
B) has been sued / to have supplied
C) will be sued / to supply
D) is being sued / to supply (Passive)

38. My grades so much that I more revision.

- A) fell / had needed
B) are falling / have needed
C) will fall / needed
D) have fallen / need (Verb Tenses)

39. He clearly remembers by the window the people outside rushing to their office.

- A) having stood / watching
B) standing / to watch
C) to stand / having watched
D) D) to have stood / to watch (Gerund/infinitive/participles)

40. Milton regrets Sam her homework. Now she is worried that she will get quite a low grade in today's quiz.

- A) persuaded / to do
 - B) being persuaded / to do
 - C) persuading / to do
 - D) having persuaded / doing
- (Gerund/infinitive/participles)

41. It is crucial that the managerwithout any delay after such an embarrassing transaction.

- A) Resigned
 - B) Resign
 - C) resigns
 - D) will resign
- (Noun clauses/ rep. speech)

42. What is important for us now is not happened, but caused this all.

- A) what / who
 - B) where / whom
 - C) why / what
 - D) how / where
- (Noun clauses/ rep. speech)

43. I had to spend 5 minutes on the 3rd question and had great difficulty answering it.

I think it was of all.

- A) more confusing than
 - B) as confusing as
 - C) the most confused
 - D) the most confusing
- (adj./adv.)

44. Enrica seems very desperate because she is typing to complete the monthly sales report.

- A) too slowly
 - B) much slowly
 - C) rather slowly
 - D) fast enough
- (adj./adv.)

45. The study of the situation covers a great deal of relevant material, but does not tackle the real issues enough.

- A) Outrageously
- B) vaguely
- C) currently
- D) adequately

(vocabulary)

46. Serbian in Bosnia has been strongly condemned by the civilized world, but little serious action has been taken against it.

- A) settlement
- B) conduct
- C) treaty
- D) investment

(vocabulary)

47. Many of the pictures sent from outer space are presently on in the public library.

- A) account
- B) duty
- C) exchange
- D) display

(vocabulary)

48. In view of the severe economic recession, his appointment to this office was regarded as highly

- A) refutable
- B) appropriate
- C) considerable
- D) compulsory

(vocabulary)

49. Organizations are often said to be theatres in which people roles in dramas, and psychic prisons, or political arenas.

- A) perform
- B) allege
- C) betray
- D) presume

(vocabulary)

50. The lawyer submitted to the court several documents to his point of view.

A) support

B) overcome

C) improve

D) alienate

(vocabulary)

51. From the evidence, it seems pretty obvious that someone the office sometime during the night.

A) found out

B) took after

C) broke into

D) ran up

(vocabulary)

52. The scientist was able **to evoke** powerful emotions from her audience.

Evoke means:

A) Sell

B) Calm

C) Call forth

D) Exaggerate

53. Oriental medicine ————— the mind and the body as one inseparable unit.

A) thinks

B) foresees

C) believes

D) regards

(vocabulary)

54. If I on holiday to Vlora, I wouldn't have met Dana.

A) didn't go

B) haven't gone

C) hadn't gone

D) would not have gone

GJUHË FRËNGE

PËR DOKUMENTACIONIN

- 1.** Këshilli i disiplinës në shkollë është :
 - A) një organ vendimmarrës për problemet e shkollës
 - B) një organ i bordit të prindërve
 - C) një organ këshillimor I drejtorit të shkollës
 - D) një organ ekzekutiv i këshillit të mësuesve

- 2.** Mbështetur në udhëzimin e MASH" Për zhvillimin e orëve të lira" shëno se cila nga këto veprimtari nuk mund të ushtrohet gjatë orëve të lira?
 - A) projekte kurrikulare
 - B) modele kurrikulare
 - C) teste kontrolli
 - D) veprimtari interaktive

- 3.** Bazuar në aktet normative nxënësi ndaj të cilit merret masa për përjashtim nga shkolla ka të drejtën e ankimit brenda
 - A) 5 ditëve
 - B) 2 javëve
 - C) 10 ditëve

- 4.** Përveç orëve të lira që planifikohen për përforsim, orët e tjera planifikohen për:
 - A) përsëritje paralele
 - B) veprimtari shkollore
 - C) zëvendësim orësh
 - D) realizimin e programit

PER PROGRAMIN

- 5.** Vendimi për përdorimin e orëve të lira me qëllim përforsimin e lëndës merret:
 - A) nga mësuesi i lëndës
 - B) nga drejtori i shkollës

- C) nga ekipi i kurrikulës
- D) nga Drejtoria arsimore

6. Quelles sont les quatre compétences qui se développent chez les apprenants l'enseignement des langues étrangères?

7. Përkufizoni ndryshe objektivin minimal.

QUESTIONS SUR LE NIVEAU MÉTHODOLOGIQUE

8. Notez sur le tableau des documents visuels et des documents sonores servant à l'enseignement d'une langue étrangère

documents visuels	des documents sonores
-------------------	-----------------------

9. A quoi servent les bilans à la fin des unités dans les manuels scolaires?

10. Quelles sont les composantes de la compétence communicative?

CONNAISSANCES LINGUISTIQUES

11. Mettez l'article qu'il faut:

- a) Pour votre demande de congé, l'accord _____ directrice est obligatoire.
- b) La bibliothèque _____ lycée restera ouverte.
- c) Le président _____ Université a annoncé la suppression de dix postes.
- d) Nous avons des problèmes _____ éducation.

12. Mettez il y a, ça fait, pendant, depuis, combien de temps dans les phrases.

- a) tu es rentrée _____ combien de temps ?
- b) tu es à Paris _____ combien de temps ?
- c) il est resté _____ combien de temps à Madrid ?
- d) moi j'ai terminé _____ au moins dix minutes.

13. Complétez les phrases suivantes avec ce / c' / ça / cela

- a) Tu viendras chez Pierre ? - _____ m'étonnerait !

- b) Tu as passé une bonne soirée ? –Ah oui _____ était super.
c) Voilà mon travail _____ n'est pas parfait mais je n'ai pas pu faire mieux.
d) Les films d'aujourd'hui sont pas très intéressants _____ prouve que les metteurs en scène trouvent des sujets attirants pour le publique.

14. Soulignez le temps correct dans les phrases suivantes :

- a) Il viendra nous voir aussitôt qu'il le (pouvait, pourra, pu)
b) Une fois qu'il (partira, part, sera parti) je regarderai un film vidéo.

15. Trouvez l'adjectif définissant un trait de caractère.

Je trouve le temps long quand je suis avec lui. Il est.....

Je ne crois jamais ce qu'elle dit .elle est

Elle n'aime pas parler quand il y a beaucoup de monde. Elle est.....

C'est impossible de faire changer d'avis. Il est

Elle exagère avec ses vêtements , elle est

16. Choisissez l'option correcte:

Julie n'est pas là? – non elle est partie _____

- A) aussitôt
B) tout à coup
C) tout de suite
D) à l'instant même.

17. Choisissez l'option correcte:

Je ne crois pas qu'il _____ malade.

- A) est
B) soit
C) était
D) a été

18. Récrivez ce texte en utilisant l'adjectif "tout" quand cela est possible:

Le soir on sort du lycée et le matin, il faut être à l'arrêt du car avant 7 heures sauf bien sûr le mercredi. Chaque semaine se ressemble, chaque mois est identique.

Chacun est triste et fatigué. La classe rêve de vacances qui n'en finiraient pas.

19. Continuez les phrases pour exprimer le résultat dans le présent:

Ex: J'ai trop dormi et je ne suis pas en forme. (plusieurs variantes possibles, à vous de choisir).

1. Il a toujours été bizarre _____
2. Je n'ai rien compris _____
3. On a eu des résultats _____
4. Nous avons roulé toute la nuit _____

20. Faites des phrases en choisissant un élément de chaque colonne. Tous les éléments doivent être utilisés.

Comme	bibliothèque	augmente	ravager	du DELF
Grâce à	les incendies	j'ai	aux examens	aussi
Dans ma	la crise mondiale	il	des livres	les forêts
En Grèce	son travail	continuent à	les prix	d'une grande valeur

21. Vous exercez déjà un métier, sinon vous avez choisi celui que vous exercerez dans l'avenir. Exposez les raisons de votre choix. (150 mots)

HISTORI

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Objektivat e arritjeve të nxënësve për kapitull mësuesi i shkruan:

- A) në fillim të planit mësimor vjetor.
- B) te ditari i mësuesit në fillim të kapitullit.
- C) në fillim të ditarit.
- D) në regjistër.

2. Si vepron mësuesi për të vlerësuar nxënësin me notë n.q.s. ai ka munguar mbi 40% të orëve të mësimit në një lëndë me/pa arsye gjatë një semestri?

3. Cili vendos se për çfarë do të përdoren lekët që u kërkohen prindërve?

- A) Bordi i shkollës
- B) Drejtori i shkollës
- C) Këshilli pedagogjik
- D) Mësuesi kujdestar

PËR PROGRAMIN

4. Orët e lira për përforcimin e lëndës mund të përdoren:

- A) për të plotësuar orët e pazhvilluara nga mësuesi për ndonjë arsye.
- B) për të zhvilluar përgatitje të nxënësve të talentuar për olimpiada.
- C) për zhvillimin e provimeve të kapitujve.
- D) kur një pjesë e nxënësve nuk arrin objektivat minimale të një kapitulli.

5. Cili është objekti i studimit të lëndës “Njohuri për historinë botërore të shekullit XX”:

6. Cila nga temat e kapitujve nuk i përket programit analitik të lëndës Histori - klasa VII?

- A) Perandoritë e mëdha të lindjes në shekujt XII-XV
- B) Monarkitë absolute evropiane në shekujt XV-XVIII
- C) Perandoria osmane dhe Ballkani në shekujt XVI-XIX
- D) Ndryshimet ekonomike dhe shoqërore në shekujt XVII-XVIII

7. Përmendni tri tema mësimore të lëndës “Qytetërimet e hershme dhe mesjetare botërore”-klasa e VI, që rimerren në lëndën “Njohuri mbi historinë e popullit shqiptar”-klasa IX:

PËR METODIKËN

8. Dy pjesët më themelore të një objektivi janë:

- A) objekti dhe veprimtaria
- B) objekti dhe kriteri
- C) veprimtaria dhe kushti
- D) veprimtaria dhe kriteri

9. Diagrami i Venit është një teknikë që mësuesi e përdor për të evidentuar:

- a) _____ e koncepteve, dukurive apo personazheve historikë.
- b) _____ e koncepteve, dukurive apo personazheve historikë.

10. Listoni tre prej kritereve që mësuesi merr në konsideratë për ndarjen e klasës në grupe:

11. Përmendni tri ndër rolet e mësuesit në mësimdhënien me në qendër nxënësin? Përgjigje:

12. Përdorimi i pyetjeve në etapa të ndryshme të orës së mësimi shërben:

- A) për të krijuar një komunikim të lirshëm.
- B) për të zbuluar nivelin e njohurive të nxënësve.
- C) për të nxitur mendimin e nxënësve.
- D) të gjitha.

13. Pyetjeve me përgjigje të lirë i takojnë:

- A) pyetjet ese të pastrukturuara.
- B) pyetjet e vërtetë/ e gabuar.
- C) pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë.
- D) pyetjet e strukturuara.

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

14. Përfaqësuesit e fesë kalviniste në Francë u quajtën:

- A) anglikanë
- B) kalvinistë
- C) hugenotë
- D) luteranistë

15. Kryqëzo të dy kolonat sipas lidhjeve kuptimore që kanë:

- A) Meka 1. Arabët përhapën fenë e re në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut.
- B) Medina 2. Shënon fillimin e Islamit.
- C) 622 3. Muhamedi largohet nga Meka dhe vendoset në një qytet tjetër.
- D) 632 4. Muhamedi fillon të shpallë fenë e re.

16. Marrëveshja e Vormsit u bë në vitin:

- A) 1122
- B) 1221
- C) 1078
- D) 1088

17. Përmendni dy ndër ndryshimet midis bujkrobërve dhe skllëvërve:

18. Turqit pushtuan Jeruzalemin, qyteti ku ndodhej varri i Krishtit, në vitin:

- A) 1010
- B) 1088
- C) 1077
- D) 1099

19. Në fund të shekullit XII, në qytetet e Francës veriore u shfaq stili i ri i arkitekturës, që u quajt:

- A) grotesk
- B) roman
- C) gotik
- D) salem

- 20.** Mbreti Dari sundoi në:
A) mbretërinë e Asirisë
B) mbretërinë e Babilonisë
C) mbretërinë e Egjiptit
D) mbretërinë e Persisë
- 21.** Betejën e Termopileve e udhëhoqi Mbreti Spartan:
A) Miltiadi
B) Themistokli
C) Leonidha
D) Delosi
- 22.** Fisi që jetonte në rrafshnaltën e Iranit ishte:
A) Mede
B) Etole
C) Sumere
D) Mimose
- 23.** Shkruani tri nga arsyet pse Britania ishte vendi ideal për realizimin e Revolucionit Industrial:
- 24.** Përmendni tre ndërmonarkët e Evropës perëndimore që kanë sunduar në periudhën shek. XV-XVIII.
Wird er aber im Handyzeitalter so wichtig, dass unsere Kindeskiner nur noch mit dicken Daumen zur Welt kommen? Wohl kaum, denn selbst bei zwanzig Jahre langem Training würden die Gene für einen kräftigeren Daumen nicht an die nächste Generation vererbt; und Evolution heißt, dass sich die Gene verändern. Die Natur unterstützt solche Mutationen nur, wenn sie sich als vorteilhaft für das Überleben einer Art erweisen - und danach sieht es bei der Handynutzung nicht aus.

Statt dessen sehen sich Ärzte zunehmend mit Menschen konfrontiert, die über Entzündungen an der Hand klagen. Und auch den Intellekt scheint der Einsatz des Superfingers nicht gerade zu befördern: In einer Umfrage, wieder in Japan erhoben, äußerte jeder Vierte, der Gebrauch von Handy und Computer habe seine Handschrift verschlechtert - und mehr als die Hälfte der Befragten gab zu, dass sie deshalb bereits einige Schriftzeichen vergessen hätten.

Stimmen die folgenden Aussagen mit dem Text überein?

– Kreuzen Sie an!

R F

12. Nur noch eine Minderheit der japanischen Teenager telefoniert mit dem Handy.
13. Bei vielen japanischen Teenagern übernimmt der Daumen sogar einige Funktion des Zeigefingers
14. Auch bei anderen Primaten konnte eine Weiterentwicklung des Daumens festgestellt werden
15. Offenbar hängt die Emanzipation des Daumens von den anderen Fingern mit der Entwicklung des Gehirns zusammen
16. Wer seine Daumen verliert, ist nicht mehr in der Lage, Werkzeuge und Waffen zu gebrauchen

17. Wann begann der Daumen, sich zu verändern? (Stichpunkt)

18. Wann werden Mutationen an die nächste Generation vererbt?
(Nebensatz)

Sie werden vererbt, _____ sind

19. Welche Umschreibung passt zu welcher Wendung?

- | | |
|-----------------------------------|-------------------------------------|
| 1) Es steht viel auf dem Spiel. | a) Das fällt sofort auf. |
| 2) Das wird Schule machen. | b) Sie hat durchs Schaden gelernt. |
| 3) Er lebt auf großem Fuße. | c) Das ist ein Vorbild für alle. |
| 4) Das springt sofort ins Auge. | d) Das ist eine entscheidende Sache |
| 5) Sie hat viel Lehrgeld gezahlt. | e) Er gibt viel Geld aus |

20. Die zweite Frau eines Mannes ist für die Kinder der ersten deren ...

- A) Pflegemutter
- B) Adoptivmutter
- C) Stiefmutter
- D) Schwiegermutter

21. Wenn jemand gähnt, ...

- A) hat er Angst
- B) ist es ihm zu heiß
- C) hat er Hunger
- D) ist er müde

22. Was ist falsch?

- A) Es waren rund 200 Leute da.
- B) Es waren etwas 200 Leute da.
- C) Es waren zirka 200 Leute da.
- D) Es waren ungefähr 200 Leute da.

23. "Er hat das schwierige Klavierspiel einfach vom Blatt gespielt." Das heißt:

- A) Er hat es sehr gut gespielt.
- B) Er hatte es vorher noch nie gespielt.
- C) Er hatte es sehr schlecht gespielt.
- D) Er hat das falsche Stück gespielt

24. Was kann man nicht sagen?

- A) Es fängt an zu regnen.
- B) Es regnet weiter.
- C) Es hört auf zu regnen.
- D) Es beendet zu regnen

25. Ergänzen Sie:

Sehr geehrte Damen und Herren, mein Name ist Maria Sanchez. Ich studiere (1) _____ zwei Jahren Germanistik an der Philologischen Fakultät in Madrid.

(2) _____ meine Sprachkenntnisse zu verbessern, würde ich gerne für ein oder zwei Jahre in Österreich studieren. Besonders interessiere ich mich für die Universität Salzburg, (3) _____ ich habe gehört, dass das Germanistikinsitut dort einen besonders guten Ruf hat. Außerdem (4) _____ ich Salzburg nach einem 2-monatigen Aufenthalt im Sommer 2008 bereits und habe dort auch einige Freund. Ich wollte (5) _____ nun erkundigen, ob die Möglichkeit (6) _____, einen Studienplatz am Germanistikinstitut zu bekommen. Wenn ja, möchte ich Sie ersuchen, mir die Aufnahmebedingungen für ein Studium an einer österreichischen Universität mitzuteilen. Es (7) _____ mich unter anderem interessieren, (8) _____ ich einen Nachweis meiner Deutschkenntnisse erbringen muss.

Weiters wäre ich Ihnen für Informationen über günstige Wohngelegenheiten bzw. Studentenheime(9) _____.

Ich hoffe (10) _____ Ihre baldige Rückmeldung und verbleibe

Mit freundlichen Grüßen

Eva Heller

26. Wie heißen die Präpositionen

- a) Sie waren der Meinung, dass sie sich _____ das Examen vorbereitet haben
- b) Die Bewohner im Zentrum der Stadt leiden _____ dem ständigen Lärm
- c) Der Richter war _____ der Meinung des Zeugen einverstanden.
- d) Henry ist gut _____ Mathe

27. Bilden Sie Nebensätze

- a) Trotz des miserables Essen hat sie zugenommen.
- b) Für ihre Karriere tut sie alles.

- c) Aufgrund eines Stipendiums kann Isabella einen Deutschkurs in Deutschland besuchen
- d) Nach dem Abitur studierte sie für das Lehramt am Gymnasium

28. Ergänzen Sie:

- a) Das Buch, _____ Umschlagzerrissen war, habe ich neu binden lassen
- b) Wie teuer ist der Computer, _____ Sie im Angebot haben?
- c) Die Frau, _____ ich geholfen habe, war mir sehr dankbar.

29. Es liegt _____ ihm, dir zu helfen

- A) an
- B) in
- C) vor
- D) zu

30. _____ dieser Zeit, d.h. im 18. Jahrhundert, reiste man mit Kutschen

- A) dank
- B) an
- C) zu
- D) von

31. Ich verlasse mich _____ seine Ehrlichkeit.

- A) an
- B) auf
- C) zu
- D) in

32. Obwohl wir uns sehr geeilt haben, haben wir den Zug . _____

- A) genommen
- B) verpasst
- C) gelungen
- D) erreicht

33. Leider _____ ich nicht länger bei dir bleiben

- A) soll
- B) will
- C) muss
- D) kann

34. Meistens machen wir ein Picknick und wir übernachten ja auf Campingplätzen, gestern auf einem supermodernen, der gerade an diesem Tag

- A) eröffnet worden ist
- B) eröffnet wird
- C) eröffnet worden sind
- D) eröffnete

35. Kann ich dein Buch noch ein paar Tage behalten?...

- A) Leider habe es ich noch nicht ausgelesen.
- B) Leider ich habe es noch nicht ausgelesen.
- C) Leider habe ich es noch nicht ausgelesen
- D) Leider habe noch nicht ich es ausgelesen

36. In unseren Flüssen starb eine _____ Zahl von Fischen.

- A) alarmierene
- B) alarmierte
- C) alarmierendste
- D) alarmierende

37. Er hatte das Stellenangebot ganz zufällig _____ Herumblättern in der Zeitung gefunden.

- A) beim
- B) zwischen den
- C) seit
- D) während

38. Welches Wort ist nicht korrekt? Jeder Satz hat nur einen Fehler.

- a) So schnell wie damals rollte der technischen Fortschritt noch nie
a b c d
- b) Er erklärt, dass er von das Unfall nichts gesehen habe.
a b c d
- c) Wiederholt ihn einfach die Geschichte?
a b c d
- d) Als wichtigste Neuerung gilt heute in Rückblick die Dampfmaschine.
a b c d

SOCIOLOGJI

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Norma e ngarkesës mësimore (NNM) e një mësuesi, në përputhje me lëndën, ciklin dhe shkollën përcaktohet:
 - A) ministri i Arsimit dhe të Shkencës
 - B) nga DAR
 - C) nga bordi i shkollës
 - D) nga drejtori i shkollës

2. Sipas dispozitave normative, mësuesi **nuk** ka për detyrë:
 - A) të zbatojë me korrektësi legjislacionin shkollor;
 - B) të silltet me etikë demokratike e rofesionale,
 - C) ta njohë mirë lëndën ose lëndët që jep në shkollë,
 - D) të zgjidhet në organizma konsultative, që veprojnë në shkollë

3. Lëvizjet në punë të mësuesve, si punëmarrës, bëhen në përputhje me:
 - A) Kodin e Punës
 - B) Dispozitat normative
 - C) Ligjin për arsimin parauniversitar
 - D) Asnjë nga të mësipërmet

4. Te udhëzimi “për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve kërkohet që minitestit të zhvillohet nga:
 - A) mësuesi i lëndës për objektivat e një ore mësimore
 - B) mësuesi i lëndës për objektivat e një kapitulli
 - C) drejtori i shkollës për objektivat e një kapitulli
 - D) drejtori i shkollës për objektivat e një ore mësimore

PËR PROGRAMIN

5. Zbatimi cilësor i programit, nuk kërkon nga mësuesi:
 - A) të zbatojë me përpikëri programin lëndor
 - B) të kërkojë materiale shtesë që sqarojnë më mirë objektivat e programit lëndor

- C) të ofrojë shanse të reja kurrikulare përtej atyre që ofron programi dhe teksti shkollor
- D) a dhe b së bashku

6. Kërkesat që ushtron ndaj shkollës mjedisi vendor duhet të njihen nga mësuesi:

- A) Për të zbatuar më mirë kurrikulën zyrtare
- B) Për të hartuar kurrikulën në bazë shkolle
- C) Për të përballuar presionin që politika vendore ushtron ndaj kurrikulës zyrtare
- D) A dhe B

7. Për realizimin e synimeve të lëndës, mësuesi duhet të bazohet:

- A) Në kërkesat e programit lëndor
- B) Në tekstin e nxënësit
- C) Në përvojën e tij vetjake
- D) Në të gjitha më sipër

E vërtetë apo e gabuar?

- 8. *Kurrikula në bazë shkolle* synon kryesisht të vendosë kritere për të matur arritjet e nxënësve në nivel vendor, _____
- 9. Përcaktimi në program i objektivave realiste dhe në përputhje me mundësitë e nxënësve është parim themelor i kurrikulit ***gjithëpërfshirës***,
- 10. Është synim i kurrikulës së lëndëve shoqërore të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, _____
- 11. Zbatimi cilësor i programit të lëndës së sociologjisë kërkon nga mësuesi të kërkojë materiale shtesë që sqarojnë më mirë objektivat e programit lëndor _____

PËR METODIKËN

12. Nga mësuesi kërkohet gjithmonë që:

- A) të trajtojë të gjithë nxënësit me respekt,
- B) të dëgjojë mendimin e nxënësve,
- C) të jetë model për sjelljen dhe mënyrën e të menduarit të nxënësve
- D) A dhe B

13. **Perenializmi**, një ndër drejtimet filozofike arsimore, mbron idenë se “nxënësit duhet të fitojnë ato njohuri që bartin ide të mëdha”. Sipas **perenializmit**, qëllimi kryesor i kurrikulës është të sigurojë që nxënësit:

- A) të kenë njohuri të mjaftueshme për të gjetur kuptimin e tyre në jetë
- B) të zhvillohen nga pikëpamja intelektuale në fushën e artit dhe të shkencave
- C) të dinë si të përmirësojnë shoqërinë ku jetojnë
- D) të zhvillojnë ndjenjën e vetëvlerësimit

14. **Bihevizorizmi** mbështetet në idenë se “mësuesit mund të arrijnë që nxënësit të shfaqin sjelljet e dëshiruara prej tyre, përmes kontrollit të kujdesshëm të mjedisit arsimor dhe përdorimit të teknikave të përshtatshme të përforcimit”. Pra, sipas **bihevizorizmit**:

- A) Sjelljet e dëshiruara të nxënësve nuk mund të arrihen asnjëherë
- B) Nxënësit duhet të ndjekin çështjet e tyre në jetë
- C) Sjellja njerëzore nuk përcaktohet nga kushtet e mjedisit
- D) Sjelljet e dëshiruara njerëzore mund të jenë më shumë produkt i planifikimit se sa i rastësisë

E vërtetë apo e gabuar

15. Pohimet për atë **çfarë mësuesit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të** bëjnë rreshtohen nga ato që janë konkrete dhe të veçanta tek ato që janë abstrakte dhe të papërcaktuara

16. Përshkrimi që mësuesit i bëjnë punës së tyre është gjithmonë konkret dhe i saktë

- 17.** Një nga sfidat më të mëdha të mësuesve është të si të shmangin trysinë për vëmendje të veçantë që shpesh kërkojnë nxënësit me arritje të ulëta në mësim
- 18.** Lidhur me faktorët e shumtë që ndikojnë tek të nxënit, është më e saktë të thuash se mësuesit:
- A) janë në gjendje të kontrollojnë të gjithë faktorët që ndikojnë te të nxënit
 - B) nuk janë në gjendje të kontrollojnë as edhe një nga këta faktorë
 - C) nuk duhet të përpiqen të kontrollojnë ndonjë nga këta faktorë
 - D) mund të kontrollojnë vetën pak nga këta faktorë
- 19.** Shkruani 3 objektiva të lëndës së sociologjisë që u takojnë 3 niveleve të aftësive intelektuale
- Objektivi 1. Niveli i ulët:
- Objektivi 2. Niveli mesatar:
- Objektivi 3. Niveli i lartë:.....

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

- 20.** Krahasuar me normat, vlerat janë më:
- A) të rëndësishme
 - B) abstrakte
 - C) detyruese
 - D) të dukshme
- 21.** Të dhënat historike tregojnë se në procesin e zhvillimit të kulturës:
- A) janë shtuar nxitjet agresive të njerëzve, por janë bërë më të njerëzishme marrëdhëniet ndërmjet tyre
 - B) janë pakësuar nxitjet agresive të njerëzve, por marrëdhëniet ndërmjet tyre nuk janë shumë të njerëzishme
 - C) janë pakësuar nxitjet agresive të njerëzve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre janë shumë të njerëzishme
 - D) janë shtuar nxitjet agresive të njerëzve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre nuk janë shumë të njerëzishme.

- 22.** Gjatë periudhës shumëshekullore të pushtimit të Shqipërisë nga Turqia, kultura përparimtare shqiptare është zhvilluar si:
- A) nënkulturë
 - B) kundërkulturë
 - C) ksenocentrizëm
 - D) difuzion
- 23.** Cili prej elementëve të mëposhtëm të kulturës, është kusht i domosdoshëm për funksionimin normal të institucioneve publike?
- A) ekzistenca e normave kulturore
 - B) gjuha e huaj
 - C) gjuha e shkruar
 - D) simbolet kulturore
- 24.** Në kulturën e vendit tonë ndryshon më shpejt:
- A) mënyra si lidhen dy bashkëshortë
 - B) mënyra e pritjes së mikut në shtëpi
 - C) mobilimi i shtëpisë
 - D) marrëdhëniet ndërmjet brezave
- 25.** Divorci dhe rimartesa që pasojnë njëra-tjetrën si dukuri sot quhen:
- A) monogami seriale
 - B) poligami seriale
 - C) endogami
 - D) ekzogami
- 26.** Ndikohet më pak nga lidhjet fisnore familja:
- A) patriarkale
 - B) familja e hapur
 - C) familja bërthamë
 - D) b dhe c
- 27.** Tabuja e incestit është normë kulturore që ndalon martesën ndërmjet:
- A) individë të të njëjtit seks
 - B) individë me lidhje shumë të afërt gjaku
 - C) një të rrituri me një të mitur
 - D) asnjë nga të mësipërmet

- 28.** Mesazhet bëhen gjithnjë e më pak personale në komunikimin.
- A) Ndërpersonal
 - B) Në grupe
 - C) Masiv
 - D) Vetvetor
- 29.** Personaliteti i çdo njeriu përfshin mënyrat si ai:
- A) mendon për vete dhe për botën
 - B) reagon emocionalisht në situata të ndryshme
 - C) vepron në jetën e përditshme
 - D) të gjitha të mësipërmet.
- 30.** Teknologjia moderne ndryshon nga shkenca sepse:
- A) zhvillohet me metoda kërkimore sistematike
 - B) mund të arrijë rezultate duke u mbështetur vetëm në përvojën praktike
 - C) është mjet për zbatimin në praktikë të parimeve shkencore
 - D) të gjitha të mësipërmet.
- 31.** Ekologjia urbane shpreh:
- A) punën e shkencëtarëve për të minimizuar ndotjet e mëdha të mjedisit
 - B) bashkëveprimin e mjedisit fizik dhe të jetës shoqërore në qytete
 - C) shkencën që studion shkaqet e ndotjes së mjedisit
 - D) A dhe C.
- 32.** Një ndër format më të skajshme të paragjyqimeve është:
- A) fanatizmi
 - B) racizmi
 - C) intoleranca
 - D) paragjyqimi institucional.
- 33.** Largimi i banorëve nga zonat qendrore të qyteteve të mëdhenj dhe sistemimi i tyre në rrethina quhet:
- A) shpërngulje urbane
 - B) shpërqendrim urban
 - C) zhvillim periferik
 - D) asnjë nga të mësipërmet

- 34.** Kur shkencëtarët, të trembur nga konkurrenca, i mbajnë sekret arritjet e tyre, ata shkelin idealin shkencor të:
- A) universalizmit
 - B) dyshimit të organizuar
 - C) komunalitetit
 - D) painteresueshmërisë
- 35.** Nuk është tipar i komunikimi masiv:
- A) rritja e numrit të pjesëmarrësve që marrin pjesë në të
 - B) mesazhet e komunikimit masiv janë fryt i punës së përbashkët
 - C) mesazhet bëhen gjithnjë e më personale
 - D) realizimi i tij përmes teknikave dhe organizmave komplekse
- 36.** Detyrimi i organeve ekzekutive është:
- A) të miratojë ligje në përputhje me kushtetutën
 - B) të sigurojë zbatimin e ligjit
 - C) të vendosë drejtësi në rastet e shkeljes së ligjit
 - D) të gjitha detyrimet e mësipërme.
- 37.** Funksionimi i demokracisë kërkon që:
- A) pushteti politik të përqendrohet në dorën e një institucioni kushtetues më të rëndësishëm në një vend
 - B) pushteti politik të përqendrohet në dorën e një personi të vetëm me shumë autoritet
 - C) pushteti politik të mos jetë i përqendruar në dorën e një institucioni të vetëm
 - D) A dhe B
- 38.** Ndarja e pushteteve në demokraci bëhet që:
- A) ato t'i shërbejnë më mirë të njëjtit interes
 - B) të shmangët përqendrimi i tepruar i pushtetit nga një njeri ose grup i vetëm
 - C) degët e pushtetit të ruajnë pavarësinë e plotë nga njëra-tjetra
 - D) asnjë nga të mësipërmet

E vërtetë apo e gabuar?

- 39.** Paragjykimet janë përshkrimet e kategorive të ndryshme të njerëzve, të cilat vazhdojnë edhe përballë fakteve që i kundërshtojnë, _____
- 40.** Një ndër faktorët që i shtyjnë njerëzit të braktisin zonat qendrore të qyteteve është rritja e përzierjes së popullsisë me përkatësi racore, etnike e shoqërore të ndryshme, _____
- 41.** Ndarja e pushteteve në demokraci bëhet që degët e pushtetit të ruajnë pavarësinë e plotë nga njëra-tjetra, _____
- 42.** Në demokraci, “Elita” e fiton pozitën e saj për shkak të pozitës së saj të veçantë në shoqëri, _____
- 43.** Një ndër funksioneve të fesë që shfaqet kur disa norma kulturore të rëndësishme shenjtërohen prej besimeve fetare është krijimi shoqëror i së shenjtës, _____
- 44.** Martesa përcakohet si:
- 45.** Raca është:
- 46.** Institucionet janë
- 47.** Shpjegoni përmbajtjen e vlerave që dallohen si më origjinale në kulturën shqiptare?
- 48.** Vendndodhja gjeografike e Shqipërisë, shturja e mëvonshme e rendit feudal në Shqipëri, qenia e tri besimeve të mëdha fetare në Shqipëri, pushtimet e shumta dhe qenia e zonave të lira, janë disa nga faktorët më veprues që kanë ndikuar në ekzistencën e një mozaiku të larmishëm nënkulturash në Shqipëri? Listoni tre të tjera:
- 49.** Teoritë kryesore që shpjegojnë devijancën janë?
- 50.** Në studimet e proceseve urbane quhet:
1. Revolucioni i parë urban _____

2. Revolucioni i dytë urban _____
3. Revolucioni i tretë urban _____

51. Shkruani tre nga katër format kryesore sipas të cilave zhvillohen marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne.

52. Në përgjithësi faktorët themelorë që modelojnë një demokraci janë:

53. Roli i partive politike shfaqet më shumë në periudhën e zgjedhjeve.
Në këtë drejtim, funksionet e partive politike janë:

54. Idetë se demokracia prodhon tiranë, errëson ushtrimin e pushtetit të vërtetë, frenon risitë dhe krijimet, janë disa nga argumentet që i kundërvihen demokracisë. Cilët janë tre argumente të tjerë?

EKONOMI

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Struktura e vitit mësimor për çdo kategori shkolle përcaktohet në planin mësimor përkatës të miratuar nga:
 - A) Ministri i Arsimit dhe i Shkencës
 - B) Këshilli i Ministrave
 - C) Parlamenti
 - D) Drejtoritë Rajonale
2. Puna mësimore - edukative, PME, në çdo shkollë mbështetet, në radhë të parë, në realizimin cilësor të disa pjesëve kryesore të Kurrikulës Kombëtare. Për çfarë bëhet fjalë?

Shënoni S për pohimin e saktë dhe G për pohimin e gabuar

3. Fillimi dhe mbarimi i vitit shkollor është kompetencë e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

PËR PROGRAMIN

4. Objektivat e arritjeve të nxënësve për kapitull mësuesi i shkruan:
 - A) në fillim të planit mësimor vjetor.
 - B) te ditari i tij në fillim të kapitullit
 - C) në fillim të ditarit
 - D) në regjistër
5. Politika monetare, politika fiskale, kërkesa dhe oferta tërësore, papunësia, matja dhe format e saj dhe inflacioni janë tema të kapitullit "Stabiliteti ekonomik". Listoni tri temat e tjera të këtij kapitulli.
6. Sipas programit mësimor të ekonomisë, në një kapitull studjohet kërkesa dhe oferta. Për këtë analizohen disa koncepte analoge edhe për kërkesën edhe për ofertën. Për cilët koncepte bëhet fjalë?

PËR METODIKËN

7. Për temën mësimore “Prodhimi dhe funksioni i prodhimit” hartoni 3 objektiva sipas taksonomisë konjitive të Blumit: një për nivelin e parë, një për nivelin e dytë dhe një për nivelin e tretë.

8. Hartoni një pyetje të strukturuar dhe bëni pikëzimin e saj. Shpjegoni pse merret çdo pikë:

9. Zgjidhni një temë dhe hartoni një ditar me të paktën tre pjesë të domosdoshme të tij.

Shënoni S për pohimin e saktë dhe G për pohimin e gabuar

10. Kompetenca e mësuesit në fushën e zotërimit të **pedagogjisë** së mësimdhënies shprehet kryesisht në aftësinë për të përdorur metoda dhe ecuri në përshtatje me objektivat e kurrikulës dhe nevojat e nxënësve_____.

11. Vlerësimi i nivelit të dijeve, shprehive dhe aftësive praktike të nxënësit është çështje e rëndësishme dhe e pandarë e të gjithë PME në shkollë_____.

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

12. Kostoja oportune pasqyron koston e të mirave dhe shërbimeve të marra nga:

- A) zyra e statistikës
- B) indeksi i çmimit të konsumatorit
- C) çmimi i çdo gjëje që është blerë
- D) çfarë është sakrifikuar me qëllim që të merren të mira dhe shërbime

13. Një ulje e çmimit të energjisë elektrike zhvendos në të majtë lakoren e kërkesës për:

- A) ngrohëset që përdorin vajgurin
- B) llampat
- C) tharëset elektrike
- D) tharëset elektrike dhe llampat

- 14.** Kërkesa është e lidhur pozitivisht me të ardhurat për mallra:
- A) inferiorë
 - B) normalë
 - C) plotësues
 - D) zëvendësues
- 15.** Në tregun e produkteve bujqësore, nëse çmimi i plehrave kimikë ulet, atëherë mund të pritët që:
- A) oferta e produkteve bujqësore të rritet
 - B) oferta e produkteve bujqësore të ulet
 - C) kërkesa e produkteve bujqësore të rritet
 - D) çmimet e produkteve bujqësore të rriten
- 16.** Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk shkakton rritje në kërkesën për atë mall?
- A) rritja e të ardhurave
 - B) ulja e të ardhurave
 - C) ulja e çmimit të një malli zëvendësues
 - D) ulja e çmimit të një malli plotësues
- 17.** Cila nga rritjet e mëposhtme do të provokojë një zhvendosje djathtas të lakores së mundësive të prodhimit:
- A) e të ardhurave të konsumatorëve
 - B) e nivelit të eksporteve
 - C) e produktivitetit të punës
 - D) e subvencioneve dhe mallrave industrialë
- 18.** Nëse për një produkt ekziston kërkesë e tepërt, atëherë:
- A) lakorja e ofertës do të zhvendoset djathtas
 - B) çmimi i mallit duhet të bjerë
 - C) kërkesa duhet të zhvendoset majtas për të penguar inflacionin
 - D) çmimi i mallit duhet të rritet
- 19.** Nëse çmimi i secilit prej produkteve të mëposhtme ulet 20%, cili prej tyre do të kishte rritjen më të madhe të sasisë së kërkuar:
- A) buka
 - B) qumështi
 - C) ushqimi i restoranteve
 - D) syzat optike

- 20.** Fakti që gjalpi ka margarinën si një zëvendësues të afërt në konsum e bën:
- A) ofertën e gjalpës më elastike
 - B) ofertën e gjalpës më pak elastike
 - C) kërkesën për gjalpë më elastike
 - D) kërkesën për gjalpë më pak elastike
- 21.** Kanë ofertë elastike të mirat dhe shërbimet që:
- A) janë me shumicë
 - B) sigurohen me vështirësi
 - C) sigurohen lehtësisht
 - D) janë të reja në treg
- 22.** Çfarë nënkupton eficensa, barazia dhe siguria ekonomike si kritere për dallimin e sistemeve ekonomike nga njëri-tjetri?
- 23.** Pse firmat e vogla ndodhen përballë rrezikut të dështimit?
- 24.** Shpjegoni dy nga përparësitë e korporatave:
- 25.** Krahasoni aksionet e zakonshme me ato të parapëlqyera:
- 26.** Përse është e domosdoshme mbajtja dhe studimi i kontabilitetit të biznesit?
- 27.** Analizoni ç'ndodh me çmimin e ekuilibrit të një malli:
- a) kur lakorja e kërkesës zhvendoset majtas ndërsa lakorja e ofertës zhvendoset djathtas _____
 - b) Po nëse lakorja e kërkesës zhvendoset djathtas dhe lakorja e ofertës zhvendoset majtas? _____
 - c) Paraqitini grafikisht të dy rastet.
- 28.** Jepni me fjalë përcaktimin për:
- a) produktin marxhinal fizik _____
 - b) prodhimin si proces _____
- 29.** Kostoja e përgjithshme mesatare është e barabartë me raportin e kostos:

- A) së përgjithshme të pandryshueshme me sasinë mesatare të prodhuar
B) së përgjithshme me sasinë e produktit të prodhuar
C) marxhinale të përgjithshme me sasinë mesatare të prodhuar
D) të ndryshueshme të përgjithshme me koston e pandryshueshme
- 30.** Argumentoni kundërshtimet për deficitin buxhetor dhe borxhin publik:
- 31.** Si mund të pakësohen deficitet buxhetore?
- 32.** Shpjegoni thelbin e papunësisë:
a) friksionale _____
b) strukturore _____
c) ciklike _____
- 33.** Pse politika monetare është e kufizuar?
- 34.** Pse i përdor Banka e Shqipërisë:
a) marrëveshjen e riblerjes _____
b) rifinancimin _____
c) normën e rezervës së detyrueshme _____
- Shënoni S për pohimin e saktë dhe G për pohimin e gabuar*
- 35.** Lakorja e ofertës për punë ka pjerrësi pozitive. _____
- 36.** Qeveria vendos me ligj nivelin e pagës minimum. _____
- 37.** Roli i qeverisë si menaxher shprehet në sigurimin e të drejtave dhe të pronës private. _____
- 38.** Konkurenca nxit prodhimet e parapëlqyera nga konsumatorët. _____
- 39.** Roli i veçantë i motivit për të përfituar në një ekonomi tregu është se dekurajon njerëzit sepse duhet të përballojnë rrezikun. _____

FILOZOFI

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Si anëtar i anëtar i bordit të shkollës mësuesi:
 - A) Caktohet nga drejtori i shkollës
 - B) Caktohet nga kryetari i bordit të shkollës
 - C) Zgjidhet me votim nga mësuesit e shkollës
 - D) Zgjidhet me votim nga bordi i shkollës

2. Sipas dispozitave normative, vlerësimi i bëhet i njohur nxënësit, si dhe prindërve në takimet periodike me ta, të paktën:
 - A) Një herë në muaj.
 - B) Një herë në tre muaj
 - C) Një herë në javë
 - D) Çdo ditë

3. Objektivat e arritjeve të nxënësve për kapitull, duhet të shkruhen nga mësuesi:
 - A) në fillim të ditarit
 - B) në regjistër
 - C) në planin mësimor vjetor
 - D) në ditarin e mësuesit në fillim të kapitullit

4. Orët e lira për përforcimin e lëndës mund të përdoren
 - A) për arritjen e objektivave minimalë të një kapitulli, të paarritura nga një pjesë e nxënësve
 - B) për të zhvilluar përgatitje për nxënësit e talentuar
 - C) për zhvillimin e testimeve për kapitujt
 - D) për të zëvendësuar orët e pazhvilluara nga mësuesi

PËR PROGRAMIN

5. Synim i kurrikulës së lëndëve shoqërore është
 - A) të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike

- B) të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës
- C) të sigurojë dhe të forcojë bindjen ndaj politikave të shtetit demokratik
- D) A dhe B

6. Nuk bën pjesë në programin e lëndës së filozofisë:

- A) aftësia për të dyshuar në autoritet.
- B) aftësia për të mbrojtur me argumente një qëndrim të caktuar.
- C) aftësia për të bindur të tjerët
- D) aftësia për të respektuar mendimin e tjetrit

7. Për realizimin e synimeve të lëndës, mësuesi duhet të bazohet më shumë:

- A) Në kërkesat e programit lëndor
- B) Në tekstin e nxënësit
- C) Në përvojën e tij vetjake
- D) Në të gjitha më sipër

8. Të sigurojë që nxënësit të arrijnë standardet arsimore:

- A) Është synimi parësor i kurrikulës
- B) Nuk është synim parësor i kurrikulës
- C) Nuk ka të bëjë fare me kurrikulën
- D) Asnjë nga të mësipërmet

E vërtetë apo e gabuar

9. Kurrikula në bazë shkolle duhet të hartohet në përputhje me kërkesat për të hyrë në ciklin më të lartë të shkollimit (universitet)

10. Programet lëndore duhet të kenë si kriter nevojën për përditësimin e kurrikulës

11. Zbatimi cilësor i programit, nuk kërkon nga mësuesi forcimin e rolit të tij si bartës i njohurive dhe i aftësive

PËR METODIKËN

12. Nuk është e saktë të pohohet që mësimdhënia e lëndëve shoqërore në shkollë kërkon nga mësuesi:

- A) të trajtojë të gjithë nxënësit me respekt
- B) të jetë model për sjelljen e nxënësve
- C) të dëgjojë mendimin e nxënësve
- D) të mësojë prej nxënësve

13. Mësimdhënia në thelb është një çështje filozofike sepse ajo lidhet:

- A) me atë që ka qenë në të kaluarën
- B) me atë që duhet të jetë
- C) me atë që është
- D) me atë që do të jetë në të ardhmen

14. Sipas progresivizmit, “qëllimi i arsimit duhet të përcaktohet nga nevojat dhe interesat e nxënësve”. Sipas progresivizmit të nxënësve:

- A) duhet të bazohet në arritjet më të mëdha të njerëzimit
- B) duhet jetë më shumë aktiv se pasiv
- C) duhet jetë më shumë pasiv se aktiv
- D) duhet të bazohet në motivet e brendshme

15. Esencializmi, si filozofi arsimore, mbron pikëpamjen se “shkolla duhet t’u mësojë nxënësve një thelb njohurish dhe aftësish në mënyrë sistematike dhe të disiplinuar. Sipas esencialistëve fëmija:

- A) nga natyra është “i keq” dhe ka nevojë të disiplinohet me dhunë
- B) nga natyra është “i mirë” dhe disiplina do ta pengojë të shprehë aftësitë e tij
- C) ka nevojë për udhëzime të qarta dhe të drejtpërdrejta që lidhen me vlerën e disiplinës dhe të punës
- D) arrin vetë të ideja e disiplinës

E vërtetë apo e gabuar

16. Përcaktimi i objektivave realiste dhe në përputhje me mundësitë e nxënësve nuk është parim themelor i kurrikulit gjithëpërfshirës.

17. Përshkrimi që mësuesit i bëjnë punës së tyre në një farë shkalle është i paqartë dhe i pasaktë.
18. Sjelljet e nxënësve nuk janë të rëndësishme për vlerësimin e mësuesve.
19. Një nga sfidat më të mëdha të mësuesve është të mësojnë ku të përqendrojnë energjitë dhe burimet e tyre në klasë.
20. Shkruani 3 objektiva të lëndës së filozofisë që u takojnë 3 niveleve të aftësive intelektuale
Objektivi 1. Niveli i ulët:
Objektivi 2. Niveli mesatar:
Objektivi 3. Niveli i lartë:.....

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

21. Kur lindi filozofia si profesion?
A) Në shekujt VIII-VII p.l.K.
B) Në shekujt IV-III p.l.K.
C) Në shekujt VI-V p.l.K.
D) Në shekujt II-I p.l.K.
22. Cili është përcaktimi më i saktë për filozofinë:
A) shkencë që mbështetet te eksperimenti
B) dije reflektive
C) dije objektive
D) shkencë mbi shkencat
23. Shprehja “të zgjosh një shpirt drejt filozofisë do të thotë t’i mësosh atij tronditjen” është ide e:
A) Hesiodit
B) Talesit
C) Sokratit
D) Anaksimandrit

- 24.** Nocioni i përvojës në Rilindje u ngrit kundër:
- A) vizionit magjik të natyrës
 - B) idhujve të racës
 - C) induksionit
 - D) interpretimit të natyrës
- 25.** “Primum vivere, deinde philosophari” do të thotë që akti i mendimit filozofik:
- A) vjen në fund të jetës së njeriut
 - B) përputhet në kohë me përpjekjet për mbijetesë
 - C) vjen pasi plotësohen nevojat materiale
 - D) i paraprin plotësimin të nevojave materiale të njeriut
- 26.** Themelues i shkollës së parë filozofike është:
- A) Pirroni
 - B) Talesi
 - C) Platoni
 - D) Plotini
- 27.** Shqetësimi intelektual është element nxitës i:
- A) sofizmit
 - B) refleksionit filozofik
 - C) hapësirës si intuitë
 - D) skepticizmit
- 28.** Shkolla e parë filozofike u krijua në:
- A) Babiloni
 - B) Milet
 - C) Damask
 - D) Kostandinopojë
- 29.** Parimi për ta marrë jetën si udhërrëfyese i përket:
- A) stoicizmit
 - B) skepticizmit
 - C) sofizmit
 - D) platonizmit

30. Sipas Aristotelit filozofia:

- A) është mënyra se si e vërteta reflektohet te ne
- B) studjon shkaqet dhe parimet e para
- C) siguron lumturinë e njeriut
- D) nis nga format në vetvete

31. Miti është një mënyrë për të menduar botën sipas një rregullsie të paracaktuar. Kjo ide i takon:

- A) Sokratit
- B) Epikurit
- C) Hesiodit
- A) Pitagorës

32. Kërkimi për një element thelbësor që qëndron në themel të gjithçkaje që ne shikojmë, është karakteristikë e filozofisë:

- A) antike greke
- B) analitike
- C) së Rilindjes Evropiane
- D) së historisë

33. Cili pohim i mëposhtëm shpreh më mirë ndryshimin ndërmjet një teologu dhe filozofi?

- A) Filozofi spekulon me mendimin, teologu jo.
- B) Teologu thekson besimin, filozofi thekson arsyen.
- C) Teologu spekulon me mendimin, filozofi jo.
- D) Teologu dhe filozofi nuk kanë ndonjë ndryshim.

34. Çdo pasojë e ka një shkak. Gjithashtu çdo shkak është pasojë e një shkakut paraprak, deri në pafundësi. Rrjedhimisht duhet të ekzistojë një shkak fillestar që ka prodhuar të gjithë shkaqet dhe pasojat. Ky është Zoti. Ky arsyetim është:

- A) prova e dytë e Thoma Aquinit për ekzistencën e Zotit
- B) prova e dytë e Shën Agustinit për ekzistencën e Zotit
- C) prova e pestë e Shën Agustinit për ekzistencën e Zotit
- D) asnjë nga të mësipërmet

35. Hegeli flet për një arsye që:

- A) mbrohet bashkë me lirinë
- B) shpaloset në histori
- C) gjykohet nga ligji moral
- D) lufton egoizmat njerëzorë.

36. Për Kantin, historia:

- A) është një proces i rëndësishëm për njerëzimin
- B) është një proces tërësisht irracional dhe i paparashikueshëm
- C) ka një qëllim natyror
- D) përbëhet nga ngjarje që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën

37. Me cilën nga deklaratat e mëposhtme do të ishte dakord Hegeli:

- A) arsyeja është në vetvete irracionale
- B) irracionalja është e domosdoshme për realizimin e arsyes
- C) irracionalja nuk ekziston pasi gjithçka ka një arsye
- D) irracionalja është në vetvete e arsyeshme

38. Pyetja e Dekartit "A ekzistoj unë" shpreh:

- A) një shqetësim, një tronditje
- B) frymë kritike ndaj gjithçkaje
- C) iluzionin e një qëllimi përfundimtar
- D) vlerësim për metodën e induksionit

39. Frojdi, kur shprehet se "UNI nuk është zot në shtëpinë e vet", do të thotë që:

- A) njeriu nuk duhet të ndrydhet nga shoqëria.
- B) njeriu ka zbuluar aftësitë e tij për të bërë analizën e vetvetes.
- C) njeriu ndryshon marrëdhënien e të kaluarës me të tashmen.
- D) individi nuk e njeh kurrë veten e vet

40. Teoria intelektualiste shprehet që besimi përcaktohet nga:

- A) qartësia e brendshme e idesë
- B) vullneti
- C) arbitri i lirë
- D) ideali moral.

41. Mund të quhet ndryshe “*e drejtë rationale, morale, ideale...*”

- A) e drejta natyrore
- B) e drejta pozitive
- C) e drejta ndërkombëtare
- D) e drejta kushtetuese.

42. Duke analizuar ndryshimin ndërmjet asaj që bëjmë dhe asaj që jemi, një filozof ka shkruar: Ne luajmë për të tjerët atë subjekt që të tjerët duan prej nesh, por që ne nuk e kemi. Kjo tregon se marrëdhëniet shoqërore karakterizohen nga një lloj hipokrizie. Kujt i përket ky arsytim?

- A) Haidegerit
- B) Montenjtit
- C) Frojdit
- D) Sartrit

43. Formula e Sartrit është:

- A) ekzistenca paraprind thelbin
- B) thelbi paraprind ekzistencën
- C) ekzistenca e thelbi janë një.
- D) ekzistenca nuk ka lidhje me thelbin.

Plotësoni

44. Si e trajton nocionin “e tjetrit” psikologjia:

45. Për Platonin, të filozofosh do të thotë:

46. Sipas skeptikëve, një prej momenteve më të rëndësishëm për të qenë i lumtur është:

E vërtetë apo e gabuar?

47. Filozofët iluministë mendonin se përmirësimi dhe reformimi shoqëror dhe politik mund të arrihej më mirë nëpërmjet shkollimit dhe përhapjes së dijeve që do të prodhonin një opinion publik të ndriçuar.

48. Si rrjedhojë e Revolucionit Shkencor, universi filloi të kopceptohej si një tërësi e rregulluar, e kufizuar dhe e hierarkizuar, ku çdo gjë është në vendin e vet në përputhje me natyrën e vet

49. Në Gjermani lëvizja Sturm und Drang (Stuhi dhe Vrull) ishte një grupim shkrimtarësh, poetësh dhe dramaturgësh të rinj që u mblodhën rreth Herderit dhe Gëtes për t'iu kundërvënë racionalizmit iluminist

50. Pozitivizmi logjik synonte të bazonte logjikën mbi arsyetimin metafizik

51. Sipas Paskalit, një sistem deduktiv si ai i gjeometrisë bazohet mbi terma të paprovueshëm, siç janë aksiomat, prandaj bazohet edhe mbi intuitën

52. Për Kantin, Hapësira është plotësisht konceptuale, sepse është e mundur që ajo të racionalizohet plotësisht.

53. Hajdegeri ishte filozofi i parë, idetë e të cilit iu kundërvunë traditës filozofike dhe u bënë baza e ekzistencializmit

Plotësoni përgjigjet e sakta

54. Në filozofi, humanizimi përmes punës shprehet në tri pohimet e mëposhtme

55. Në mendimin filozofik ka dy drejtime që analizojnë raportin e së drejtës me shoqërinë. Pyetjet që rryma dhe autorë të ndryshëm bëjnë në kritikën e këtyre drejtimeve janë: - Si do të bëhet arbitrimi i interesave të kundërt?
- Si mund të kuptohet roli i reformatorëve?

Për cilat drejtime bëhet fjalë? Shkruani emrin e njërit prej autorëve.

56. Në analizën e moralit filozofia mund të dallojë tre nivele të ndërgjegjes. Përcaktoni këto tre nivele.

57. Tri çështjet kryesore të cilave u përpoq t'u jepte përgjigje Frojdi me teorinë e të pandërgjegjshmes janë.

58. Tri prej arsyeve pse "gjuha" e kafshëve nuk është gjuhë në kuptimin njerëzor janë.

59. Te njeriu, kohësia përbëhet nga tre aspekte: e ardhmja, e tashmja dhe e kaluara. Në cilët akte të shpirtit bazohen këto aspekte?

HISTORI

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Në pëfundim të semestrit të parë, nxënësi x rezulton se ka mbi 50% mungesa në histori. Në qoftë se llogariten notat që ai ka marrë, rezulton kalues. Si do të veproni ju në këtë rast?
 - A) Do ta quani kalues për semestrin e I.
 - B) Do ta quani mbetës.
 - C) Do ta merrni në provim për lëndën që ka munguar.
 - D) Do ta raportoni në drejtorinë e shkollës që ajo të marrë vendim.
2. Cilat janë autoritetet e arsimit në Republikën e Shqipërisë?
Plotëso fjalitë e mëposhtme.
 - a) Në nivel kombëtar: _____
 - b) Në nivel vendor: _____
 - c) Në nivel shkolle: _____

PËR PROGRAMIN

3. Konceptin globalizëm, faktorët që çojnë drejt tij, problemet globale, etj., në cilën prej historive të mëposhtme nxënësi i gjen të trajtuara:
 - A) Historinë e Mesjetës
 - B) Historinë e Kohës së Re
 - C) Historinë Botërore të shek. XX
 - D) Në asnjërin prej varianteve A, B, C
4. Në cilin prej kapitujve të mëposhtëm bën pjesë tema “Republika e Vajmarit”:
 - A) Totalitarizmi komunist dhe fashist
 - B) Vendet e Ballkanit
 - C) Marrëdhëniet ndërkombëtare
 - D) Demokracitë perëndimore në vitet 1918 – 1938
5. Paraqitja sa më objektive e ngjarjeve në “Historinë e lashtë dhe të mesjetës botërore” realizohet nëpërmjet:

6. Objektivi i përgjithshëm lëndor: “Nxënësit të jenë të hapur për të diskutuar në mënyrë të argumentuar ndaj pikëpamjeve të ndryshme mbi zhvillimin historik të shoqërisë njerëzore të shekullit XX duke dalluar faktet nga opinionet” synon të aftësojë nxënësit për:

- A) Kronologjinë
- B) Kërkimin historik
- C) Interpretimin historik
- D) Gjerësinë e njohurive historike

7. Objekti i studimit të Historisë Bashkëkohore Botërore është:

PËR METODIKËN

8. Në interpretimin e një ngjarjeje historike nxënësi duhet të shmangë:

- A) Faktet historike
- B) Analizën e fakteve
- C) Kujtimet e bashkëkohësve
- D) Opinionet e ndryshme

9. Shkruaj tri folje që përdoren në formulimin e objektivave të nivelit të lartë në lëndën e historisë:

10. Mjet i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi që nxit të menduarit është përdorimi i metodave ku në qendër të orës së mësimi është nxënësi. Cili nga pohimet e mëposhtme është pjesë e këtyre metodave? Qarko. Argumentoni përgjigjen.

- A) stuhia e mendimeve
- B) shpjegimi
- C) ligjërata
- D) demonstrimi

11. Pyetjeve me përgjigje të lirë i takojnë:

- A) pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë
- B) pyetjet ese të pastrukturuara
- C) pyetjet e vërtetë/ e gabuar
- D) pyetjet e strukturuara

12. Si klasifikohen pyetjet në bazë të përmasës së tyre? Shkruaj 4 prej tyre.

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

- 13.** Në periudhën e kalimit në Republikë Romake mbreti u zëvendësua me:
- A) diktatorin
 - B) kalorësit
 - C) konsujt
 - D) princepsin
- 14.** Për Hamurabin ligjet kishin për synim:
- 15.** Qytetërimi i sotëm i është mirënjohës qytetërimit babilonas, pasi ai i dha njerëzimit:
- A) idenë e sistemit juridik të sumerianëve.
 - B) organizimin e shoqërisë sumeriane.
 - C) idenë dhe praktikën e forcës së ligjit.
 - D) organizimin shtetëror në Mesopotami.
- 16.** Reformat e Solonit zvogëluan fuqinë politike të:
- A) familjeve të vjetra aristokratike.
 - B) eupatridëve dhe aeropagut.
 - C) fshatarëve të varfër.
 - D) qytetarëve të lirë burra.
- 17.** Përfaqësia e përgjithshme në Francë përfaqësonte:
- A) shtresat e larta të shoqërisë.
 - B) interesat e të gjithë shoqërisë.
 - C) shtresat e ultra të shoqërisë.
 - D) interesat e larta të mbretit.
- 18.** Arsyeja kryesore që mbretërit e Evropës kundërshtuan pushtetin e papës në shek.XVI ishte:
- A) morale
 - B) politike
 - C) ekonomike
 - D) shpirtërore
- 19.** Përmend dy nga arsyet përse Luteri kërkonte reformimin e kishës katolike?

- 20.** Luigji XIV i përmbahej teorisë se fuqia e sundimit të tij mbështetej tek:
- A) “E drejta hyjnore”
 - B) “Mbreti diell”
 - C) “Shteti jam unë”
 - D) “Shteti mbi fenë”
- 21.** Përmend tre prej shkaqeve të konfliktit mbret-parlament në Anglinë e shekullit XVII:
- 22.** Parimet kryesore të merkantilizmit ishin:
- 23.** Iluministi që u shpreh se e drejta ka vetëm një burim ‘popullin’ është:
- A) Loku
 - B) Monteskje
 - C) Ruso
 - D) Volter
- 24.** Pabarazia politike e shoqërisë franceze të shek.XVIII qëndronte tek:
- A) idetë iluministe
 - B) kriza financiare
 - C) pushteti politik
 - D) reforma fiskale
- 25.** Cili pohim është i vërtetë në lidhje me reformën arsimore të ndërmarrë nga Mustafa Qemal Ataturku:
- A) Futja e një alfabeti të ri me shkronja latine në gjuhën turke.
 - B) U unifikua arsimi mbi baza kombëtare.
 - C) Arsimi u bë më demokratik dhe laik.
 - D) Të gjitha.
- 26.** Cilit udhëheqës i atribuohet platforma politike e “mosbindjes civile” nëpërmjet qëndresës pasive?
- A) Mao Ce Dun
 - B) Mohandas Gandi
 - C) Sun Jat Sen
 - D) Aleksander Cankov

- 27.** Listo tre nga tipat e lëvizjeve sociale që ekzistojnë sot në botë ?
- 28.** Cili nga pohimet e mëposhtme NUK është i vërtetë për Republikën e Pestë Franceze?
- A) Presidenti kishte kompetenca të mëdha.
 - B) U ndryshua ligji elektoral nga mazhoritar në proporcional.
 - C) Roli i Asamblesë Kombëtare ishte më i kufizuar se në republikat e mëparshme.
 - D) Presidenti do të zgjidhej me votim të drejtpërdrejtë nga populli.
- 29.** Përmendni katër nga vendimet e Konferencës së Teheranit midis tre fuqive të mëdha të botës në atë kohë:
- 30.** Cila prej partive të mëposhtme politike ka qenë gjithnjë e pranishme nëpër koalicione qeveritare sepse nuk merrte dot e vetme shumicën në zgjedhje në Itali?
- A) Partia Republikane
 - B) Partia Komuniste
 - C) Partia Demokristiane
 - D) Partia Liberale
- 31.** Përmendni dy nga faktorët që ndikuan në krizën e Lindjes së Mesme:
- 32.** Pas cilës prej betejave të mëposhtme të Luftës II Botërore, SHBA vendosi epërsinë detare në Oqeanin Paqësor duke i dhënë një rrjedhë tjetër luftës?
- A) Beteja e Perl – Harborit
 - B) Beteja e Detit të Koraleve
 - C) Beteja e Miduejt
 - D) Beteja e El – Alameinit
- 33.** Në cilën prej platformave të mëposhtme u mbështet tërësisht programi “Kursi i Kufirit të Ri” i zbatuar nga Xh. Kenedi:
- A) Liberalizmin Klasik
 - B) Liberalizmin Modern
 - C) Konservatorizëm
 - D) Neokonservatorizëm

- 34.** Ku konsistonte doktrina e liberalizmit modern (Kejnsianizmi) në aspektin ekonomik?
- 35.** Përshkruani tre nga faktorët që ndikuan në rezistencën ndaj asimilimit sllav të Ilirisë së Jugut:
- 36.** Dokumenti i parë ndërkombëtar që merrte në konsideratë krijimin e një shteti shqiptar është:
- A) Marrëveshja austro-ruse e Budapestit
 - B) Traktati i Shën-Stefanit
 - C) Vendimet e kongresit të Berlinit
 - D) Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve Londër
- 37.** Për herë të parë të drejtat dhe liritë e individit në Shqipëri janë sanksionuar në dokumentin e:
- A) Kanunit të Jurisë
 - B) Kushtetutës së vitit 1946
 - C) Statutit të Lushnjës
 - D) Statutit të Zgjeruar të Lushnjës
- 38.** Lëvizjet sociale në Shqipëri në vitet 1928-1939, kishin karakter:
- A) Arsimor
 - B) Ekonomik
 - C) Politik
 - D) Emancipues
- 39.** Shënoni dy përfitime të Turqisë nga “Konventa jugosllavo-turke”:
- 40.** Kushtetuta e vitit 1976, përcaktonte si forcë lëvizëse në shoqërinë shqiptare:
- A) Mbrojtjen e interesave të punëtorëve
 - B) Mbrojtjen e vendit nga imperializmi
 - C) Luftën e klasave
 - D) Luftën kundër revizionizmit
- 41.** Asambleja e përgjithshme e OKB, ka fuqi vendimmarrëse mbi çështjet e:

GJEOGRAFI

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Ai që mban përgjegjësi penale për çrregullime e pasaktësi në amzën e shkollës është:
 - A) drejtori
 - B) nëndrejtori
 - C) sekretari
 - D) mësuesi kujdestar

2. Nxënësi ndaj të cilit merret masë disiplinore ka të drejtë ankese pranë drejtorisë së shkollës dhe DAR apo ZA:
 - A) pas 5 ditëve
 - B) brenda 5 ditëve
 - C) pas 7 ditëve
 - D) brenda 7 ditëve

3. Lidhur me fondin vullnetar të prindërve në shkollë, prindi ka të drejtë:
 - A) t'ia dorëzojë lekët drejtorit të shkollës
 - B) t'ia dorëzojë lekët kryetarit të bordit të shkollës
 - C) t'i derdhë lekët në llogarinë rrjedhëse të shkollës
 - D) t'ia dorëzojë lekët mësuesit kujdestar të fëmijës së vet

4. Drejtori i shkollës i paraqet për miratim planin vjetor të shkollës:
 - A) bordit të shkollës.
 - B) ekipit kurrikular të shkollës.
 - C) këshillit të prindërve të shkollës.
 - D) kryetarit të bashkisë ose komunës.

PËR PROGRAMIN

5. Përmend dy prej tematikave të punëve praktike që realizohen në programin e “Gjeografisë së Shqipërisë dhe trevave shqiptare”.

6. Përmend dy nga linjat e reja që ka sjellë programi i lëndës “Shkenca e Tokës”, ndryshe nga “Gjeografia fizike e përgjithshme”.
7. Mësimi “Azia juglindore sot” i përket programit:
- A) “Gjeografia fizike e përgjithshme”
 - B) “Gjeografia e trashëgimisë natyrore”
 - C) “Gjeografia rajonale e botës”
 - D) “Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave shqiptare”
8. Përmendni dy objektiva specifik që i përkasin bllokun tematik “Atmosfera”.

PËR METODIKËN

9. Pyetjet me përgjigje të shkurtër përdoren më së shumti për të testuar objektivat e nivelit të:
- A) njohjes
 - B) zbatimit
 - C) analizës
 - D) sintezës
10. Gjatë përdorimit të pyetjeve nga mësuesi gjatë një ore mësimore është e rëndësishme të ndiqet skema:
- A) pyetje – përgjigje
 - B) pyetje – pauzë – përgjigje
 - C) pyetje – koment – përgjigje
 - D) pyetje – përgjigje – koment
11. Vendos “V” në rastet kur formulimi është objektiv specifik i saktë.
- 1) Të shpjegojë arsyet kryesore të zgjerimit të mëtejshëm të BE-së
 - 2) Të rendisë dy motive kryesore që nxitën zbulimet gjeografike sipas tekstit
 - 3) Të identifikojë në hartë zonat e mbrojtura në Shqipëri sipas klasifikimit të tyre
 - 4) Të dijë format më të përhapura të relievit, llojet më të përhapura të klimës, hidrografisë, botës bimore e shtazore
 - 5) Të pëlqejë pozitën gjeografike të Shqipërisë dhe të trevave të tjera shqiptare

- 12.** Cila nga situatat e mëposhtme është treguesi më i mirë për mësuesin që nxënësit po fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike rreth një problemi?
- A) Ata flasin rreth problemit dhe trajtimeve të tij shkencore duke u nisur nga informacionet e dëgjuara më parë
 - B) Ata fillojnë të lexojnë vetë më shumë libra dhe artikuj rreth problemit
 - C) Ata planifikojnë në mënyrë të suksesshme dhe ndërmarrin eksperimente e vëzhgime për të testuar pyetjet e ngritura gjatë diskutimeve në klasë
 - D) Ata i përgjigjen saktë pyetjeve të mësuesit mbi procedurat e përdorura pas vëzhgimit të eksperimenteve të realizuara
- 13.** Listo 3 folje të vlefshme për ndërtimin e objektivave specifik në nivelin e vlerësimit të të nxënës.

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

- 14.** Është rrjedhojë e formës sferike të Tokës:
- A) Forma e orbitës së Tokës
 - B) Madhësia e forcës së gravitetit
 - C) Mbajtja e atmosferës rreth Tokës
 - D) Zonaliteti i dukurive gjeografike
- 15.** Rrezet e Diellit bien pingul në Tropikun e Veriut. Hemisfera e veriut është më e ndriçuar se hemisfera jugore. Nata zgjat 24 h në Polin e Jugut. Toka ndodhet në këtë pozicion në datën:
- A) 21 Mars
 - B) 22 Qershor
 - C) 23 Shtator
 - D) 22 Dhjetor
- 16.** Në një hartë me shkallë 1: 100 000, gjatësia e dhënë $d = 3.5$ cm. Gjatësia në terren e kësaj distance është:
- A) 350 cm
 - B) 350 m
 - C) 3.5 km
 - D) 4.5 km

- 17.** Gjetja e qymyrgurit në Antarktidë është argument i:
- A) lëvizjeve luhatëse
 - B) lëvizjeve epirogjenike
 - C) hipotezës së Big – Bangut
 - D) hipotezës së tektonikës së pllakave
- 18.** Rrezatimi diellor i shpërndarë mbizotëron më tepër kur:
- A) ka vranësira
 - B) atmosfera është e pastër
 - C) largësia Tokë - Diell është më e vogël
 - D) largësia Tokë – Diell është më e madhe
- 19.** Përmendni dy forma relievi ku copëtimi vertikal ka vlera më të ulëta.
- 20.** Renditni tre nga pasojat e lëvizjeve luhatëse në gjeosistem.
- 21.** Lartësia e mareve ndryshon në varësi të vendndodhjes së:
- A) Hënës ndaj Tokës
 - B) Hënës ndaj Diellit
 - C) Tokës ndaj Marsit
 - D) Tokës ndaj Afërditës
- 22.** Renditni katër ligjet e gjeosistemit.
- 23.** Ekonomia në të cilën njerëzit prodhojnë vetë shumicën e artikujve që u nevojiten quhet ekonomi:
- A) e komanduar
 - B) tradicionale
 - C) e tregut
 - D) mikse
- 24.** Vendet e Evropës perëndimore e mirëpritën ndihmën e NATO-s në fillimet e Luftës së Ftohtë sepse:
- A) nuk donin të lidhnin aleance më vendet e Evropës Lindore
 - B) kishin frikën e ndonjë sulmi sovjetik
 - C) parapëlqenin aleancën me SHBA
 - D) donin të sulmonin Bashkimin Sovjetik

- 25.** Nga fisi i magjarëve kanë origjinën:
- A) Çekët
 - B) Polakët
 - C) Moldavët
 - D) Hungarezët
- 26.** Pjesa veriore e Meksikës përfshihet në zonën me klimë:
- A) Tropikale
 - B) Ekuatoriale
 - C) Subekuatoriale
 - D) Mesatare
- 27.** Qarko V nëse pohimi është i saktë dhe G nëse pohimi është i gabuar.
- a) Të gjitha kulturat kanë të zhvilluar formën e shkuar të gjuhës
 - b) Gjuha është guri themeltar i kulturës
 - c) Kanadaja ka dy gjuhë zyrtare: frëngjishten dhe anglishten
 - d) Libani është një nga vendet ku problemet fetare janë mjaft të mprehta
 - e) Shqipëria është një nga vendet e cila aplikon ekonominë mikse
- 28.** Lidhni kolonën A me kolonën B, duke vendosur përbri numrit shkronjën përkatëse.
- | | |
|------------------|---|
| 1) Mubarak | A. nxiti politikën e “dyerve të hapura” |
| 2) Naseri | B. përkrahu socializmin arab |
| 3) Sadati | C. u bë president i Egjiptit në vitin 1981 |
| 4) Qemal Atatuku | D. u përpoq t’a kthente vendin një shtet modern |
- 29.** Si burim i pastër energjetik shërben energjia:
- A) e naftës
 - B) bërthamore
 - C) gjeotermike
 - D) e qymyrgurit
- 30.** Bën pjesë në trashëgiminë jomateriale kulturore:
- A) përdorimi i gjuhës shqipe në veprat letrare
 - B) qendra urbane me vlera arkeologjike
 - C) dokumente arkivore me rëndësi historike
 - D) piktura murale

- 31.** Klima e trevave shqiptare quhet e paqëndrueshme (tekanjoze) për shkak të:
- A) ekzistencës së katër stinëve
 - B) daljes së vendit tonë në detin Mesdhe
 - C) masave ajrore që vijnë nga lindja dhe verilindja
 - D) vlerave të theksuara që marrin elementët klimatikë
- 32.** Bilanci tregtar i Republikës së Shqipërisë vitet e fundit ka qenë negativ. Ky bilanc është tregues i:
- A) varësisë ekonomike të vendit nga importet
 - B) varësisë ekonomike të vendit nga eksportet
 - C) pavarësisë ekonomike të vendit nga importet
 - D) pavarësisë ekonomike të vendit nga eksportet
- 33.** Mbeti në Serbinë Juglindore pasi Kosova u diferencua si krahinë autonome:
- A) Kumanova
 - B) Bujanovci
 - C) Grebenea
 - D) Anamali
- 34.** Përmendni tre forma të relievit bregdetar që janë krijuar gjatë bregdetit shqiptar.
- 35.** Përmendni tre nga lagunat kryesore të bregdetit të Shqipërisë.
- 36.** Përmendni tre nga veçoritë natyrore të Malësisë Pukë - Mirditë.
- 37.** Në strukturën gjinore të popullsisë së Republikës së Shqipërisë, vitet e fundit mbizotëron elementi femër në krahasim me atë mashkull. Kjo është rrjedhojë e:
- A) uljes së numrit të djemve të lindur
 - B) rritjes së numrit të vajzave të lindura
 - C) luftërave që kanë ndodhur
 - D) emigracionit të jashtëm të popullsisë
- 38.** Bëjnë pjesë në grupin e tokave jozonale në trevat shqiptare:

- A) Tokat aluvionale
- B) Tokat e hirta kafe
- C) Tokat e murrme pyjore
- D) Tokat livadhore malore

39. Përmendni tre nga shkaqet natyrore të përmytjeve në Shqipëri.

40. Përmendni dy nga dukuritë negative të klimës së Shqipërisë pas viteve '90.

41. Përmendni dy nga pasojat pozitive të emigracionit të shqiptarëve:

BIOLOGJI

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Jepni 2 shembuj, se si mund të planifikohen orët e lira në arsimin e mesëm të lartë.
2. Tregoni 2 nga detyrat e Ekipit të Kurrikulës në shkollë.

PËR PROGRAMET

3. Tregoni 2 nga arsyet pse vlerësimi formues në lëndën e biologjisë merr rëndësi të veçantë.
4. Listoni 2 tema që përfshihen tek kapitulli “Funksionet jetësore të bimëve”.
5. Jepet objektivi i Programit të Biologjisë 12, “Të analizojnë provat e paleontologjisë për prejardhjen e njeriut”; Zbërtheheni këtë objektivi të programit sipas tre niveleve (bazë, i mesëm, i lartë)

PËR METODIKËN

6. Cilat janë 3 kërkesat që duhen për të hartuar objektivat specifike?
7. Përmendni 3 nga rregullat bazë që duhet të mbahen parasysh për zbatimin e metodës së Demonstrimit.
8. Tregoni 2 nga përparësitë e punës me projekte në lëndën e Biologjisë.
9. Cilat janë 3 pikat kyçe ku duhet të mbështeten mësuesit për planifikimin e mësimdhënies në një orë mësimi.

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

10. Numri i kromozomeve autosomike në qelizat seksuale të njeriut është:

- A) 22
- B) 23
- C) 44
- D) 46

11. ARN-ja e informacionit:

- A) kopjon një nga dy spiralet e ADN-së
- B) transporton aminoacidet në ribozome
- C) përmban të njëjtat baza të azotuara si ADN
- D) është një spirale e dyfishtë

12. Bakteriofagu është?

- A) prokariot që paraziton tek bakteret.
- B) organel i qelizës bakteriale.
- C) virus që infekton bakteret.
- D) qelizë eukariote që ushqehet me baktere.

13. Antitruapat sintetizohen nga:

- A) limfocitet.
- B) trombocitet.
- C) aglutininat
- D) eritrocitet.

14. Cili nga proceset e mëposhtme zhvillohet në kushte aerobe:

- A) glikoliza
- B) fermentimi alkoolik
- C) fermentimi laktik
- D) zinxhiri i transportit të elektroneve

15. Tapa prodhohet nga:

- A) kambiumi enëzor
- B) felogjeni
- C) meristema e majave
- D) indi përçues

- 16.** Mutualizmi përfaqëson një bashkëveprim midis llojeve në të cilin:
- A) të dy llojet dëmtohen
 - B) të dy llojet përfitojnë
 - C) një lloj përfiton dhe tjetri nuk dëmtohet
 - D) një nga llojet përfiton dhe tjetri dëmtohet
- 17.** Aktina merr pjesë në ndërtimin e indit:
- A) kockor
 - B) muskolor
 - C) kërcor
 - D) nervor
- 18.** Qarkullimi i vogël i gjakut tek njeriu fillon nga
- A) barkushja e djathtë
 - B) barkushja e majtë
 - C) parabarkushja e djathtë
 - D) parabarkushja e majtë
- 19.** Tek gjitarët hormoni i prolaktinës stimulon prodhimin e:
- A) progesteronit
 - B) enzimave të gypit tretës
 - C) qumështit
 - D) glikogjenit
- 20.** Kromozomet homologe kanë:
- A) të njëjtën formë, por dimensione të ndryshme
 - B) të njëjtat gjene por të renditura ndryshe
 - C) gjene të njëjta dhe të vendosura në të njëjtën renditje
 - D) formë e dimensione të njëjta, por gjene të ndryshme
- 21.** Tregoni 3 mënyrat e transportimit të dioksidit të karbonit me anë të gjakut gjatë procesit të frymëkëmbimit qelizor.
- 22.** Kryqëzohet një gjallesë diheterozigote me një gjallesë homozigote e fshehtë për dy tipare, (për dy tipare që përcaktohen përkatësisht nga gjenet F dhe G). Tek pasardhësit formohen katër klasa fenotipike:
- 436 zotërues për të dyja tiparet

- 424 i fshehtë për të dyja tiparet
 - 72 dominant për tiparin e parë dhe të fshehtë për tiparin e dytë
 - 68 të fshehtë për tiparin e parë dhe dominant për tiparin e dytë
- a) Përcaktoni gjenotipet e klasave rikombinante
 b) Përcaktoni largësinë ndërmjet gjeneve F dhe G.

23. Tregoni 3 nga dallimet që ekzistojnë midis krimbave unazorë dhe kandrrave (insekteve).

24. Tregoni 2 nga dallimet që ekzistojnë midis transportit aktiv dhe osmozës.

25. Në tabelën e mëposhtme përballë shkronjave që tregojnë disa përbërje organike vendosni numrat që tregojnë përkatësinë e tyre:

- a. nukleotid
 - b. sakaroza
 - c. aminoacid
 - d. fosfolipid
 - e. polimer
 - f. uracil
 - g. celulozë
1. substancë që formon murin qelizor të qelizave bimore
 2. zinxhir i gjatë me monomerë
 3. bazë e azotuar që gjëndet në ARN dhe jo në ADN
 4. është disakarid
 5. molekula që formojnë proteinat
 6. është i formuar nga një grup fosfat, nga një sheqer dhe nga një bazë e azotuar
 7. është përbërëse e membranës qelizore.

përbërjet organike	funksionet përkatëse
a.	
b.	
c.	
d.	
e.	
f.	
g.	

26. Përcaktoni sa tipe gametësh mund të formohen nga një individ me gjenotip AaBbCCDDEeFf

27. Një qelizë që ka $2n=10$ kromozome i nënshtrohet ndarjes qelizore me mejozë: Përcaktoni numrin e kromozomeve që ndodhen në secilën qelizë të formuar në:

Zgjidhja e ushtrimit është e vlefshme kur shoqërohet me skemat e qelizës në secilën nga fazat e ndarjes qelizore të kërkuara më lart.

a) anafazën e parë b) metafazën e dytë c) telofazën e dytë

28. Bimët me farë klasifikohen në bimët farëzhveshura dhe bimët farëveshura.

a) Tregoni 3 nga dallimet që ekzistojnë midis bimëve farëzhveshura dhe bimëve farëveshura.

b) Tek bimët farëveshura tregoni funksionin e bërthamës vegetative.

29. Një grua me ngjyrë të syve kaf dhe grup gjaku B martohet me një burrë me ngjyrë të syve kaf dhe grup gjaku AB dhe fëmija i tyre lindi me sy të kaltër dhe grup gjaku A. Sa është propabiliteti që fëmija tjetër që ata presin të lindë të ketë grup gjaku B dhe sy kaf?

30. Në një popullatë u përcaktua se në 900 burra 45 ishin daltonikë. Sa është shpeshësia e femrave bartëse në këtë popullatë?

31. Jepni një shembull të rregullimit të tahitjes hormonele të hipotalamusit dhe adenohipofizës.

32. Listoni 3 hormone bimore dhe tregoni rëndësinë e tyre për jetën e bimëve.

33. Ç'farë përparësie kanë metodat biologjike në krahasim me metodat kimike për të luftuar dëmtuesit tek bimët?

34. Një molekulë ADN përmban 500 timinë nukleotide. Numri i lidhjeve hidrogjenore të dy zinxhirëve të saj është 2200. Sa nukleotide ka gjithsej kjo molekulë ADN-je?

KIMI

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Masat disiplinore “Qortim, Vërejtje” konsiderohen të shlyera pas një afati
A) një mujor
B) dymujor
C) tremujor
D) katër mujor
2. Listoni dy nga llojet e masave disiplinore që meren ndaj nxënësve që theyejnë rregulloren e shkolles:
3. Shkruani një nga shprehjet me të cilën vlerësohet sjellja e nxënësve

PËR PROGRAMIN

4. Në linjën koncepte fillestare në kimi nuk përfshihet koncepti:
A) masa molare
B) numri i masës
C) numri atomik
D) lidhje kimike
5. Në temën “alkoolet, gatitja dhe vetitë e tyre” studjohet:
A) fenolet
B) vetitë e etanalit
C) izomeria optike
D) formimi i fenolateve
6. Duke u bazuar në njohuritë e marra në kapitullin e lidhjeve kimike, hartoni një ushtrim me 4 alternativa, ku njëra prej tyre të jetë e saktë.
7. Cilat janë dy linjat e përmbajtjes për kurikulën e kimit të klasës 10-të, me programin e ri (që filloi të zbatohet nga shtatori 2009)
8. Shkruani dy tema mësimore për kapitullin “ Hidrokarburet e pangopura”

PËR METODIKËN

9. Për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës në arsimin bazë kërkohet të zbatohet:

- A) mësimdhënie me në qendër mësuesin
- B) shumllojshmëri në mënyrat e mësimdhënies
- C) mësimdhënie me në qendër nxënësin
- D) vetëm punë me grupe

10. Roli i mësuesit në mësimdhënien me në qendër nxënësin është:

- A) komandues
- B) partner
- C) shpjegues
- D) vetëvlerësues

11. Listoni dy nga materialet që orientojnë mësuesin gjatë mësimdhënies:

12. Ç'kuptoni me shprehjen e mëposhtëme:
“mësimdhënie me në qendër nxënësin”

13. Hartoni një esse me 6 fjali me karakteristika të mësimdhënies aktive duke përdorur disa nga foljet e mëposhtëme për një temë ose çështje mësimore tema zgjidhet nga mësuesi).

drejton, menaxhon, orienton, udhëzon, organizon, vepron, diskuton, asyeton, argumenton, zgjidh, pyet, eksperimenton, etj.

14. Punët praktike të strukturuar përgatiten nga mësuesi.

Tregoni të paktën një disavantazh të kësaj metodologjie.

15. Hartoni dy objektiva të nivelit të njohjes dhe të kuptuarit për temën

“Ndërtimi i sistemit periodik”:

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

16. Numri i moleve, që ndodhen në 4,816 molekula Li është:

- A) 0,6 mol;
- B) 0,8 mol;
- C) 0,79 mol;
- D) 0,7 mol.

17. Orientimin hapësinor të orbitaleve e përcakton:

- A) Numri kuantik spin m_s
- B) Numri kuantik orbital l
- C) Numri kuantik themelor n
- D) Numri kuantik magnetik m

18. Në atomin e elementit, $Z = 35$ numri i gjendjeve energjetike të ngopura është:

- A) 30
- B) 17
- C) 14
- D) 9

19. Është shkruar gabim formula e strukturës së njëres prej përbërjeve të mëposhtëme. Ajo është:

- A) $\text{CH}_2 = \text{CH} - \text{CH}_3$
- B) $\text{CH}_3 - \text{CH} \quad \text{CH} - \text{CH}_3$
- C) $\text{CH}_3 - \text{CH}_2 - \text{CH} = \text{CH}_2$
- D) $\text{CH} \equiv \text{C} - \text{CH}_2 - \text{CH}_3$

20. Një pllakë prej hekuri me masë 5.6 gr, e zhytur në tretësirë të sulfatit të bakrit zhvendos:



- A) 6.4 gram Cu
- B) 0.64 gram Cu
- C) 64 gram Cu
- D) 6.2 gram Cu

- 21.** Cila përbërje përftohet nga nxehja (në temperaturë të lartë) e metanoatit të kalciumit?
- A) metan
 - B) metanal
 - C) etan
 - D) etanal
- 22.** Jepen përbërjet kimike: NaOH, HCl, NH_4OH , CO_2 . Prej tyre rrjedhin tretësirat e kripërave të mëposhtme: 1. NaCl 2. Na_2CO_3 3. NH_4Cl . Cilat nga kripërat hidrolizohen?
- A) 2 dhe 3
 - B) vetëm 2
 - C) vetëm 3
 - D) 1 dhe 2
- 23.** Cili nga çiftet e mëposhtme konsiderohet sistem tampon:
- A) HCl dhe NaCl
 - B) CH_3COOH dhe CH_3COONa
 - C) KOH dhe KCl
 - D) HNO_3 dhe NaNO_3
- 24.** Për një sistem që është në ekuilibër, vlera e K ndryshon me:
- A) shtimin e një katalizatori
 - B) ndryshimin e përqendrimit
 - C) ndryshimin e temperaturës
 - D) heqja e katalizatorit
- 25.** Një nga vlerat e mëposhtme të pH mund ti takojë tretësirës së NH_4NO_3 . Ajo është:
- A) 7
 - B) 5,3
 - C) 9,2
 - D) 12,3

26. Baza e konjuguar e H_3O^+ është:

- A) H_2O
- B) OH^-
- C) H^+
- D) H_2

27. Reaksioni $2\text{NO} + 2\text{H}_2 \rightarrow \text{N}_2 + 2\text{H}_2\text{O}$ zhvillohet sipas mekanizmit:



Pranojmë se:

- A) $V = [\text{NO}]^2 \times [\text{H}_2]^2$
- B) është i rendit të trete , me dy stadi 3 dhe 2 molekulare
- C) është 2 molekulare dhe i rendit të dytë
- D) është i rendit 2 ndaj NO dhe i rendit 2 ndaj H_2

28. Ndryshimi midis teorisë së Radhëfordit dhe asaj të Bohrit për modelin e atomit qëndron në:

- A) numrin e niveleve energjike në atom
- B) konceptin për qëndrueshmërinë e atomit
- C) numrin e grimcave që lëvizin rreth bërthamës
- D) sasinë e energjisë që thithet apo çlirohet nga e

29. Përzihet 200 ml tretësirë 0.8 M e hidroksidit të kaliumit me 250 ml tretësirë 0.4 M acid nitrik. Masa në g e nitratit të kaliumit, që përfitohet, është:

- A) 6.9
- B) 7.5
- C) 8.6
- D) 10.1

30. Njëri nga reaksionet e mëposhtme ndodh në katodë gjatë elektrolizës së tretësirës ujore të H_2SO_4 . Ai është:

- A) $2\text{H}^+ + 2\text{e}^- \rightarrow \text{H}_2$
- B) $4\text{OH}^- \rightarrow 2\text{H}_2\text{O} + \text{O}_2 + 4\text{e}^-$
- C) $2\text{SO}_4^{2-} \rightarrow \text{S}_2\text{O}_8^{2-} + 2\text{e}^-$
- D) $\text{SO}_4^{2-} + \text{H}_2 \rightarrow \text{H}_2\text{SO}_4 + 2\text{e}^-$

- 31.** Për reaksionin $X + a Y = C$ jepet informacioni i mëposhtëm:
I. përqendrimi i substancave rritet 3 here,
II. shpejtësia e reaksionit rritet 27 here. Vlera e “a” është:
A) 1
B) 2
C) 3
D) 4
- 32.** Cila nga kripërat e mëposhtme kur tretet në ujë nuk e ndryshon vlerën e pH?
A) CH_3COONa
B) KCl
C) $(\text{NH}_4)_2\text{SO}_4$
D) $\text{Al}(\text{NO}_3)_3$
- 33.** Një nga përbërjet e mëposhtme është në gjendje të gaztë:
A) C_7H_{12}
B) C_6H_{10}
C) C_5H_8
D) C_4H_8
- 34.** Shkruani reaksionin e bashkëveprimit të klor -2 butanit me natrium metalik:
- 35.** Njihsoni sa litra klor adiconohen nga 2.24 litra propen
- 36.** Gjeni pH e tretësirës së klorurit të amonit NH_4Cl me përqendrim 0.1 M. Konstantja e shpërbashkimit të hidroksidit të amonit është $K_b = 10^{-5}$.
- 37.** Duke u bazuar në vendin që ka elementi në sistemin periodik, listoni tre elementë që formojnë me oksigjenin përbërje me lidhje kovalente.
- 38.** Në natyrë ndodhen atome Mg në raporte 78.70% ^{24}Mg ; 10.13% ^{25}Mg ; 11.7% ^{26}Mg . Gjeni masën atomike të krahasuar të atomit të Magnezit
- 39.** Analiza elementare e një përbërje organike ka dhënë këto rezultate:



40 % C, 6.67 % H, 53.33 % O. Dëndësia e përbërjes organike në lidhje me heliumin ($Z=4$) është 7.5. Të gjendet formula molekulare e përbërjes organike duke ditur që kjo përbërje jep reaksionin e pasqyrës.

40. Produkti i tretshmërisë i sulfatit të plumbit është 1.6×10^{-8} . Gjenerimi i tretshmërisë në gramë për litër të sulfatit të plumbit në 500 ml tretësirë 0.01 M të $\text{Pb}(\text{NO}_3)_2$.

41. Konstantja e shpejtësisë së reaksionit: $\text{A} + 2 \text{B} \leftrightarrow 3 \text{C}$ është e barabartë me 0.6. Përqendrimet fillestare të substancave janë $[\text{A}] = 2 \text{ mol/l}$ $[\text{B}] = 2.5 \text{ mol/l}$. Si pasojë e reaksionit, përqendrimi i substancës B bëhet 0.5 mol/l.

Të llogaritet përqendrimi i substancës A dhe shpejtësia e reaksionit.

42. Duke bërë skemën e këmbimit elektronik, vendosni koeficientët në reaksionet redoks:



43. Është dhënë barazimi: $3\text{NO}(\text{g}) = \text{N}_2\text{O}(\text{g}) + \text{NO}_2(\text{g})$ $\Delta H = -155.8 \text{ KJ}$

a) Njehsoni entalpinë standarte të formimit të $\text{N}_2\text{O}(\text{g})$.

$$(\Delta H_{\text{NO}(\text{g})}^\circ = +90.4 \text{ KJ/mol}, \Delta H_{\text{NO}_2(\text{g})}^\circ = +33.8 \text{ KJ/mol})$$

b) Ç'sasi nxehtësie çlirohet kur në reaksion përftohet 0.5 mole NO_2 ?

44. Në tretësirën 0.1 M të HCN, konstantja e shpërbashkimit është $7.2 \cdot 10^{-10}$. Përcaktoni vlerën e pH dhe gradën e shpërbashkimit

45. Jepen përbërjet e oksigjenuara: MgO, CaO, SrO. Tregoni:


a) cili prej oksideve shfaq veti bazike më të theksuara

b) cili nga metalet Mg, Ca, Sr ka vlerë të elektronegativitetit më të vogël


c) cili nga jonet e tyre Mg^{2+} , Ca^{2+} , Sr^{2+} , ka veti oksiduese më të theksuara

46. Emërtoni përbërjet.

a)



b)



47. Ndërtoni formulat strukturore:

- a) izopropil -1, nitro -4, benzen
- b) acidi orto metil, benzen sulfonik

48. Emërtoni përbërjet:

- a) C₄H₉NH₂ _____
- b) C₈H₁₆O _____

FIZIKË

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Si veprohet kur nxënësi mbush 20 % të mungesave?
2. Tek udhëzimi “Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve” kërkohet që:
 - A) minitesti të zhvillohet nga drejtori për objektivat e një kapitulli.
 - B) minitesti të zhvillohet nga mësuesi i lëndës objektivat e një kapitullit.
 - C) minitesti të zhvillohet nga mësuesi i lëndës për orën mësimore.
 - D) minitesti të zhvillohet nga drejtori i shkollës në fund të një ore mësimore.
3. Drejtori i shkollës i paraqet për miratim planin vjetor të shkollës:
 - A) kryetarit të bashkisë ose komunës.
 - B) këshillit të prindërve të shkollës.
 - C) bordit të shkollës.
 - D) ekipit kurrikular të shkollës.

PER PROGRAMIN

4. Si mendoni, është më mirë të zhvillohet në fillim kapitulli “Forcat dhe Barazpesha”(Ekuilibri) apo kapitulli “Dinamika” Ligjet e Njutonit?
5. Çfarë veçorish duhet të ketë një program mësimor cilësor? Listo katër veçori
6. Dualizmi valor korpuskular përbën një njohuri fizike që trajtohet në kapitullin e:
 - A) Teorisë se relativitetit
 - B) Mekanikës kuantike
 - C) Valëve elektromagnetike
 - D) Mekanikës klasike

PËR METODIKËN


7. Si do të veproni nga ana metodike për kontrollin e njohurive në linjën e lëvizjes së njëtrajtshme?
8. Si do të trajtoni nga ana metodike temën: “Lëvizja e grimcave të ngarkuara në fushën elektrike”?
9. Si do të ishte me mirë nga ana metodike organizimi i detyrës së kontrollit, duke dhënë katër ushtrime me nivel të njëjtë, apo 8 ushtrime të shkallëzuara?
10. Cilat nivele të aftësive të nxënësve, sipas taksonomise se Blum-it, përfshihen në nivelin bazë të vlerësimit?
11. Shkruaj tri metoda e teknika të hulumtimit:
12. Cilat janë metodikat bazë të mësimdhënies në shkollat tona?

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

13. Grafikët paraqesin varësinë e kordinatës nga koha për dy trupa C dhe D.

Në çastin e kohës $t=10s$,

- A) C ka shpejtësi më të madhe se D,
- B) D ka shpejtësi më të madhe se C,
- C) C dhe D kanë të njëjtën shpejtësi,
- D) C lëviz me nxitim konstant.



14. Automobili me masë 1 ton, që lëviz me shpejtësi 36 km/h fillon të frenojë deri sa të ndalet . Puna e forcës së fërkimit është:

- A) $0,5 \cdot 10^4$ J
- B) $3,6 \cdot 10^4$ J
- C) $-5 \cdot 10^4$ J
- D) $5 \cdot 10^4$ J

15. Dy planetë A dhe B kanë të njëjtin nxitim afër sipërfaqes së tyre, por planeti B ka rrezën dy herë më të madhe se planeti A. Nëse masa e planetit A është M , sa do të jetë masa e planetit B?


- A) M
- B) $2M$
- C) $4M$
- D) $6M$

16. Një trup me masë 100g , lihet i lirë të bjerë nga lartësia 40m pa shpejtësi fillestare. Impulsi i trupit kur ai ndodhet në gjysmën e lartësisë do të jetë:

- A) $1.5\text{ kg}\cdot\text{m/s}$
- B) $1.8\text{ kg}\cdot\text{m/s}$
- C) $2.0\text{ kg}\cdot\text{m/s}$
- D) $4.5\text{ kg}\cdot\text{m/s}$

17. Forca F zbatohet në fundin e një dërrase homogjene me gjatësi l dhe peshë 50N . Këndi që formon drejtimi i forcës me dërrasën është 30° . Skaji tjetër i dërrasës është fiksuar në mur. Sa do të jetë vlera e kësaj force në mënyrë që dërrasa të qëndrojë në pozicionin horizontal?

- A) 25N
- B) 50N
- C) 75N
- D) 100N



18. Fluksi magnetik përmes një bobine me N spira ndryshon me 0.05Wb gjatë 0.5s . Sa do të jetë numri i spirave në qoftë se f.e.m është 5V ?

- A) 5
- B) 50
- C) 150
- D) 200

19. Në qarkun RLC, $R = 40\Omega$, $X_C = 30\Omega$, $X_L = 60\Omega$, janë lidhur në serime një burim rryme me vlerë efektive 120V. Sa është vlera efektive e rrymës që kalon në qark?

- A) 2.4A
- B) 3A
- C) 4A
- D) 5A

20. Një lavjerës i thjeshtë matematik largohet me 10cm nga pozicioni i ekuilibrit dhe lihet i lirë. Frekuenca në këtë rast është 4Hz. Sa do të jetë frekuenca e lavjersit në qoftë se lavjersin e largojmë nga pozicioni i ekuilibrit 5cm?

- A) 2Hz
- B) 4Hz
- C) 6Hz
- D) 8Hz

21. Dy burime koherente prodhojnë valë më gjatësi **2m** dhe amplitudë **A**. Një pikë M e cila ndodhet 4m nga burimi i parë dhe 5m nga burimi i dytë e ka amplitudën e lëkundjes rezultante:

- A) 2A
- B) A
- C) A/2
- D) 0

22. Në reaksionin bërthamor, ${}_{92}^{235}\text{U} + {}_0^1\text{n} \rightarrow {}_{56}^{141}\text{Ba} + {}_{36}^{92}\text{Kr} + \text{neutrone}$, numri i neutroneve është:

- A) 3
- B) 2
- C) 1
- D) Zero


23. Izotopi radioaktiv i jodit e ka periodën e gjysmezberthimi 8 dite. Një kampion është ruajtur në laborator për 16 ditë. Gjatë kësaj kohe janë zbërthyer:

- A) 1 / 4 e bërthamave
- B) 1 / 3 e bërthamave
- C) 3 / 4 e bërthamave
- D) 2 / 3 e bërthamave

24. Sfera që bie lirisht nga lartësia 125m nga toka, pasi godet atë kërcen vertikalisht lart me shpejtësi pesë herë më të vogël se shpejtësia që kishte në momentin kur takoi tokën. Njihsoni:


- Lartësinë e ngjitjes së sferës mbas momentit të parë të goditjes.
- Kohën e përgjithshme nga fillimi i lëvizjes deri në goditjen e dytë me tokën.

25. Në figurë paraqitet grafiku i varësisë së nxitimit nga koha për një trup që lëviz në një vijë të drejtë ku shpejtësia fillestare është zero.




- Ndërtoni grafikun e varësisë së shpejtësisë nga koha.
- Shpejtësinë që arrin trupi mbas 20s?


26. Dy trupa A dhe B janë në kontakt me njëri tjetrin në një rrafsh horizontal, me koeficient fërkimi $\mu=0.05$. Trupi A e ka masën 3kg dhe trupi B e ka masën 2kg. Gjeni vlerën e forcës F që duhet të ushtrohet mbi trupin A në mënyrë që të dy trupat të lëvizin së bashku me nxitim konstant 0.5m/s^2 .




27. Vagoni që lëviz me shpejtësi 72km/h, shikon përballë një pengesë. Në çfarë largësie duhet të fillojë frenimin shoferi në mënyrë që të ndalojë përpara pengesës, në rast se koeficienti i fërkimit ndërmjet rrotave dhe rrugës është $\mu=0.2$?




28. Sfera me masë $M=0.1\text{kg}$ qëndron në prehje mbi një shtyllë vertikale me lartësi 5m . Plumbi me masë $m=10\text{g}$ që lëviz horizontalisht me shpejtësi $V_0=500\text{m/s}$, godet sferën duke kaluar nga qendra e saj. Pas goditjes sfera bie në tokë në largësinë $S_1=30\text{m}$ nga këmba e shtyllës. Njihsoni largësinë S_2 të rënies së plumbit nga fundi i shtyllës.



29. Nën pistonin e një ene cilindrike ndodhet një sasi gazi në temperaturën 27°C . Sa duhet të jetë forca që duhet të ushtrohet mbi pistonin në mënyrë që temperatura e gazit të rritet deri në 127°C dhe vëllimi i gazit të zvogëlohet dy herë? Sipërfaqja e pistonit është $S = 3 \cdot 10^{-2}\text{m}^2$, $p_0=10^5\text{Pa}$. Pesha e pistonit dhe fërkimi i tij me faqet e cilindrit nuk meren në konsideratë.




30. Ngarkesa $2\mu\text{C}$ është vendosur në qendrën e sistemit koordinativ xoy , ndërsa ngarkesat $q_1=-2\mu\text{C}$ dhe $q_2=2\mu\text{C}$ janë vendosur përkatësisht në largësitë $x_1=30\text{cm}$ dhe $x_2=60\text{cm}$. Cili do të jetë drejtimi, kahu dhe vlera e forcës rezultante që vepron mbi ngarkesën e vendosur në qendër të sistemit koordinativ.




31. Jepet qarku i rrymes elektrike si në figure. ($\epsilon=200V$, dhe $r=0$)

- Sa do të jetë rezistenca ekuivalente?
- Sa do të jetë rryma në R_4 ?
- Sa do të jetë tensioni në skajet e R_5 ?




32. Shufra përcjellëse CD me gjatësi 20cm dhe rezistencë R, lëviz me shpejtësi $v=5m/s$ duke rrëshqitur pa fërkim ndërmjet dy shinave paralele si në figurë. Fusha magnetike e njëtrajtëshme është pingul me planin e figurës dhe vlera e induksionit është $B=2T$. Rezistenca e pjesëve të tjera të qarkut është papërfillshme. Fija është e pazgjatshme, masa e fijos dhe e rrotullës është e papërfillshme. Masa e trupit të varur në fije është $m=80g$ dhe $g=10m/s^2$. Përcaktoni:

- Kahun dhe intensitetin e rrymës së induktuar që kalon në shufrën CD.
- Rezistencën e kësaj shufre përcjellëse.



33. Një proton futet me shpejtësi $2 \cdot 10^6 m/s$ pingule me vijat e induksionit magnetik. Përcaktoni

- vlerën e induksionit magnetik B në mënyrë që protoni të lëviz sipas një trajektore rrethore me rreze 20cm.
- vlerën e forcës magnetike që vepron mbi protonin?



34. Trupi me masë 3 kg që është i lidhur me një sustë elasike, lëkundet me amplitudë 6 cm. Duke ditur se nxitimi maksimal është $2m/s^2$, sa është energjia e plotë e tij?

35. Në figurë është paraqitur boshti optik kryesor MN i një pasqyre sferike, pika e ndritshme objekt S dhe pika shëmbëllim S'. Me anë të ndërtimit përcaktoni:

- a) llojin e pasqyrës sferike
- b) qendrën optike të pasqyrës
- c) kulmin e pasqyrës



36. Sipërfaqja e një metali rrezatohet një herë me dritë me gjatësi vale 200 nm dhe pastaj me dritë me gjatësi vale 300 nm. Nga të dhënat eksperimentale u gjet se energjia kinetike e fotoelektroneve në rastin e dytë u zvogëlua 4 herë. Gjeni punën e daljes për këtë metal.

INFORMATIKË

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Objektivat e arritjeve të nxënësve për kapitull mësuesi i shkruan:
 - A) në fillim të planit mësimor vjetor.
 - B) te ditari i mësuesit në fillim të kapitullit.
 - C) në fillim të ditarit.
 - D) në regjistër.

2. Rrethoni dy alternativa nga pesë të shënuara për veprimtarinë në shkollë.
Shkolla në tërë veprimtarinë e saj gjithëpërfshirëse synon:
 - a) zhvillimin e mendimit dhe veprimit të pavarur, kritik, krijues, konstruktiv e tolerant
 - b) edukimin e vlerave atdhetare, njerëzore, morale e demokratike
 - c) nxitjen për të qënë të fortë fizikisht
 - d) lëvizjen e lirë të njerëzve
 - e) barazinë para ligjit

3. Tek Udhëzimi “Për hartimin e objektiveve të arritjeve të nxënësve” kërkohet që minitestit të zhvillohet:
 - A) nga mësuesi për orën mësimore.
 - B) nga mësuesi për objektivat e kapitullit.
 - C) nga drejtori për orën mësimore.
 - D) nga drejtori për objektivat e kapitullit.

PËR PROGRAMIN

4. Shkruani linjat sipas radhës për programin e:
 - a) klasës VII
 - b) klasës VIII.

5. Sa orë në javë ka lënda TIK në klasat 10, 11, 12 bërthamë dhe me zgjedhje?

7. Kur bëhet vlerësimi përmblendhës?

PËR METODIKËN

7. Cilat janë 3 kërkesat bazë për të hartuar objektivat specifike?
8. Vendos foljet e dhëna më poshtë në vendet bosh, sipas çdo niveli të Taksonomisë së Blumit:
Njih, kupton, shkruan, përkufizon, analizon, përshkruan, shpjegon, ndërton, luan, zhvillon, përdor, dallon.
1. Të njohurit _____
 2. Të kuptuarit _____
 3. Zbatimi _____
 4. Analiza _____
9. Shkruani disa nga objektivat e linjës “Përdorimi i internetit”.
10. Çfarë synon të realizojë përgjigja me gojë e nxënësit?

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

11. Plotëso vendet bosh.
- a) Software përfaqëson pjesën _____ në një kompjuter.
 - b) Më parë duhet të instalojmë programet _____, në mënyrë që të mund të hapim dhe të përdorim programet _____.
 - c) _____ është pjesa e memorjes që përdoret vetëm gjatë kohës së punës, në kompjuter.
12. Si mund të krijojmë një account (llogari në windows)?
13. Cila komandë zbatohet për të bërë një ndërprerje të kollonës kur faqen e kemi formatuar me kollona.
- A) Format Columns Column Break
 - B) Insert Page Break column
 - C) Insert Break Column Break
 - D) Format Break Column Break

14. Tregoni cilët janë komponentet e një adrese e-mail?
15. Ku mbahet përkohësisht teksti i selektuar pasi është përdorur komanda cut ose copy?
- A) Taskbar
 - B) Desktop
 - C) ROM
 - D) Clipboard
16. Cili nga simbolet e mëposhtme nuk mund të përdoret për të emëruar një dosje?
- A) +
 - B) .
 - C) /
 - D) €
17. Mega Hertz (Mhz) mat:
- A) Tingull
 - B) Shpejtesi
 - C) Hapësirë
 - D) Të trija së bashku
18. Përshkruani dy mënyra të ndryshme për selektimin e një blloku qelizash në Excel.
19. Nqs në një faqe excel-i, klikojmë tek qeliza B1 dhe duke mbajtur shtypur tastin Shift klikojmë tek qeliza G10, atëhere zona e selektuar është:
- A) B1-G10
 - B) B1.G10
 - C) B1;G10
 - D) B1:G10
20. Cili është roli i Device Manager?
21. Lidhni emrin e funksionit me përcaktimin e tij:
- Sum** Gjen vlerën më të vogël në një zonë të caktuar qelizash
- Average** Gjen numrin e qelizave joboshe
- CountA** Gjen vlerën mesatare të numrave në një zonë të caktuar qelizash
- Min** Gjen shumën e numrave në një zonë të caktuar qelizash.

- 22.** Si mund të krijojmë një *Header* në një faqe Excel?
- 23.** Duke u bazuar në të dhënat e figurës së mëposhtme, shkruani formulat e duhura në qelizat B8, C8, D8, E8, në mënyrë që më tej të përdorim autofill për të kopjuar formulën në qelizat e tjera.
- 24.** Çfarë ndodh nëse hapim një dokument nga menuja START?
- A) Windows hap programin dhe më tej hap dokumentin
 - B) Windows hap programin dhe më tej ju mund të hapni dokumentin
 - C) Në desktop hapet dritarja e My Computer në të cilën ju mund të hapni dokumentin
 - D) Hapet dritarja e Windows Explorer dhe më tej ju mund të hapni skedarin që doni
- 25.** Çfarë ndryshimi ka midis një Database dhe Database Management System (DBMS)?
- 26.** Shpjego fazat kryesore të krijimit të një prezantimi në Power Point
- 27.** Si mund të krijosh një çelës kryesor për një tabelë në Access?
- 28.** Si rezervohet një dokument? Jepni ndryshimin ndërmjet komandave Save dhe Save As:
- 29.** Shpjego procedurën e hapjes së një adrese E-mail në një nga Browser-at e internetit
- 30.** Shpjego funksionin e ndarësit të faqeve në Excel
- 31.** Prapashtesa e një skedari të përgatitur në programin Power Point është?
- A) Ppt
 - B) Xls
 - C) Odt
 - D) Doc
- 32.** Ku e shkruajmë adresën e personit që duam ti dërgojmë një kopje të fshehtë të e-mailit (marrësit e tjerë mos ta shohin)?

- A) Në fushën To:
- B) Në fushën CC:
- C) Në fushën mail:
- D) Në fushën Bcc:

33. Cili nga programet e mëposhtme quhet browser?

- A) Microsoft Outlook
- B) Internet Explorer
- C) Microsoft Excel
- D) Adobe Reader

34. Në cilën dosje të e-mailit ruhen mesazhet e ardhura?

- A) Outbox
- B) Sent item
- C) Favorites
- D) Inbox

35. Shpjegoni çfarë ndodh kur një Folder bëhet share?

36. Cili shkurtim i tastjerës bën bold tekstin e selektuar?

- A) Ctrl+B
- B) Alt+B
- C) File/Format/Bold

D) Asnjëra prej tyre

EDUKIM MUZIKOR

PËR DOKUMENTACIONIN

1. Objektivat e arritjeve të nxënësve për kapitull mësuesi i shkruan:
 - A) në fillim të planit mësimor vjetor.
 - B) te ditari i mësuesit në fillim të kapitullit.
 - C) në fillim të ditarit.
 - D) në regjistër.

2. Mësuesi, që është anëtar i bordit të shkollës:
 - A) zgjidhet me votim nga mësuesit e shkollës.
 - B) zgjidhet me votim nga bordi i shkollës.
 - C) caktohet nga kryetari i bordit të shkollës.
 - D) caktohet nga drejtori i shkollës.

3. A ka të drejtë të kryejë blerje nga fondi vullnetar i prindërve:
 - A) mësuesi lëndor?
 - B) një komision i caktuar nga drejtori?
 - C) mësuesi kujdestar?
 - D) drejtori i shkollës?

4. Tek Udhëzimi “Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve” kërkohet që:
 - A) minitesti të zhvillohet nga drejtori për objektivat e një kapitulli.
 - B) minitesti të zhvillohet nga mësuesi i lëndës objektivat e një kapitullit.
 - C) minitesti të zhvillohet nga mësuesi i lëndës për orën mësimore.
 - D) minitesti të zhvillohet nga drejtori i shkollës në fund të një ore mësimore.

PËR PROGRAMIN

5. Programi lëndor i arteve (zgjidhni atë që ju jepni) ndërtohet përmes 5 linjave kryesore. Renditi ato.

6. Përse shërbejnë objektivat e programeve lëndore?

7. Sa % të orëve të sugjeruara për secilën linjë keni të drejtë të ndryshoni në programin e lëndës tuaj.
8. Plotëso: Cilat janë lëndët që përfaqësojnë fushën e artevenë gjimnaz?
9. Si ndahet Kurrikula e gjimnazit:

PËR METODIKËN

10. Qarko përgjigjen e saktë: Sipas Taksonomisë së Blumit “*Njohja*” përfshin:
 - A) riprodhimin e diçkaje pa shpjegime
 - B) përsëritje rregullash apo emrash ashtu siç janë
 - C) nivelin më të ulët të rezultateve për nxënësit
 - D) të gjitha
11. Qarko përgjigjen e saktë: *Metoda e diskutimit* është shumë e përdorur dhe një ndër përparësitë e përdorimit është se:
 - A) mund të largohet nga qëllimi i temës
 - B) monopolizon diskutimin
 - C) krijon edukatën e të dëgjuarit të mendimit të tjerëve
 - D) asnjëra nga të tria pikat a, b, c
12. Qarko përgjigjen e saktë: Përdorimi i metodave mësimore mund të jetë:
 - A) statike në çdo orë mësimi
 - B) në varësi të përmbajtjes mësimore
 - C) në varësi të kushteve të klasës
 - D) në varësi të moshës së nxënësve
 - E) në varësi të pikave b, c, d së bashku
13. Kur ndërton pyetjet për nxënësin në klasë, mësuesi ka parasysh disa kritere. Jep dy ndër disa prej kritereve.
14. Shëno dy ndër përparësitë që ka të pyeturit me shkrim (testi) në lëndën tuaj.

15. Në sa grupe ndahen metodat e mësimdhënies?
16. Rendit metodat e mësimdhënies që përdor më shpesh duke filluar nga ato më efektive për ju.

PËR PËRGATITJEN SHKENCORE

17. Qarko përgjigjen e saktë: Muzika përcaktohet si:
- A) shprehje e emocioneve dhe ndjenjave njerëzore.
 - B) arti i modelimit emocional të tingujve me njëri -tjetrin.
 - C) një vepër artistike e kompozuar për instrument ose për zë.
 - D) radhitje tingujsh në mënyrë të pëlqyeshme për veshin.
18. Qarko përgjigjen e saktë: Muzika është një art që vendoset:
- A) në kohë
 - B) në hapësirë
 - C) në kohë dhe në hapësirë.
 - D) në një përmasë të papërcaktuar.
19. Qarko përgjigjen e saktë: Muzika shprehet me anë të:
- A) tingujve
 - B) notave
 - C) melodive
 - D) zërave dhe instrumenteve muzikore.
20. Qarko përgjigjen e saktë: Bashkëtingëllimi vertikal i dy ose më shumë tingujve dhe lëvizja e organizuar e tyre nënkupton:
- A) melodinë
 - B) harmoninë
 - C) intensitetin
 - D) ritmin
21. Qarko përgjigjen e saktë: Strofa dhe Refreni janë:
- A) elementë të muzikës
 - B) dy pjesët përbërëse të këngës
 - C) dy pjesë muzikore
 - D) parime të zhvillimit të formave muzikore

- 22.** Qarko përgjigjen e saktë: Opera është:
- A) një vepër instrumentale
 - B) një vepër vokal - skenike
 - C) një vepër simfonike
 - D) një vepër orkestrale
- 23.** Qarko përgjigjen e saktë: Hapat e parë të shkrimit të notave muzikore u hodhën në periudhën e:
- A) Mesjetës
 - B) Shekullit XX
 - C) Antikitetit
 - D) Klasicizmit
- 24.** Qarko përgjigjen e saktë: Filozofia humaniste në muzikë u shfaq nëpërmjet:
- A) reformave kishtare
 - B) zhvillimit të repertorit laik krahas atij kishtar
 - C) përsosjes së instrumenteve muzikorë
 - D) shtimit të numrit të kompozitorëve
- 25.** Qarko përgjigjen e saktë: Muzika *Barok* u zhvillua afërsisht mes viteve:
- A) 1200 – 1300
 - B) 1400 – 1550
 - C) 1600 – 1750
 - D) 1800 – 1900
- 26.** Qarko përgjigjen e saktë: Cila prej formave muzikore u konsolidua në periudhën e klasicizmit:
- A) balada
 - B) opera
 - C) sonata dhe cikli simfonik
 - D) preludi dhe fuga
- 27.** Qarko përgjigjen e saktë: Johan Sebastian Bah:
- A) është një kompozitor i njohur për krijimtarinë operistike
 - B) punoi për një kohë të gjatë në institucione fetare dhe kompozoi vetëm muzikë kishtare

- C) kundërshtoi hapur prirjet e reja në muzikë dhe në gjithë veprat e tij
- D) është një nga figurat më të shquara të muzikës, sepse arriti të bashkonte me mjeshtëri të renë e të vjetrën, duke i paraprirë zhvillimeve të mëvonshme

28. Cili prej pohimeve të mëposhtme nuk është i saktë:

- A) Lindja e operës hapi një etapë të re në historinë e muzikës botërore.
- B) Opera nuk solli ndonjë gjë të re në zhvillimet e muzikës dhe nuk është art kompleks.
- C) Opera lindi si një spektakël që gërsheton muzikën, poezinë dhe vallëzimin dhe u frymëzua nga tragjedia antike greke.
- D) Opera lindi në Firence dhe Italia u bë një nga qendrat më të rëndësishme të zhvillimit të saj.

29. Cili prej pohimeve të mëposhtme nuk është i saktë:

- A) Rikard Vagneri është kompozitor, dirigjent dhe publicist gjerman i gjysmës së dytë të shek. XIX. Ai konsiderohet si një ndër përfaqësuesit më të mëdhenj të muzikës vokale romantike.
- B) Vagneri shkroi kryesisht vepra simfonike, megjithatë ai nuk solli ndonjë risi të veçantë. U mbështet kryesisht në traditën e kompozitorëve gjermanë paraardhës.
- C) Operat e Vagnerit dallohen për karakterin fantastik – përrallor, sepse shumica prej tyre janë mbështetur në legjendat dhe mitet gjermanike.
- D) Vagneri ishte një kompozitor reformator. Ai synoi gjatë gjithë kohës të sillte diçka të re në muzikë, në ndryshim nga paraardhësit e tij.

30. Qarko përgjigjen e saktë: *Simfonia IX* nga Ludvig van Beethoven:

- A) përfaqëson një ndër veprat kulmore të muzikës klasike, në të cilën kompozitori futi për herë të parë korin dhe fjalën poetike.
- B) hap një etapë të re në zhvillimin e muzikës klasike.
- C) është shkruar nga kompozitori në periudhën e parë të krijimtarisë së tij.
- D) nuk u interpretua asnjëherë gjatë kohës që ishte gjallë kompozitori.

31. Qarko përgjigjen e saktë: Këngët gregoriane këndoheshin nga:

- A) grup fëmijësh
- B) grup miks
- C) grup burrash
- D) grup grash

- 32.** Plotëso vendet bosh në fjalitë e mëposhtme: Bethoveni në simfoninë e 9 përveç muzikës instrumentale vendosi _____ në finale dhe tekstin e Odes së shkrimtarit _____.
- 33.** Përcakto tre gjini të muzikës instrumentale dhe tre të muzikës vokale.
- 34.** Rendit disa nga personazhet e roleve kryesore të operës “Mrika” sipas zërave.
- 35.** Plotëso vendet bosh: Opera fillon me një pjesë orkestrale që quhet _____ dhe e cila mbështetet në materialin muzikor të _____.
- 36.** Shpjego me jo më shumë se 10 fjali çfarë kuptoni me termin *melodi*?
- 37.** Përshkruaj *sonatën*, duke dhënë skemën e ndërtimit të saj, si dhe duke renditur disa kompozitorë që janë shquar në këtë gjini.
- 38.** Përbri emrit të kompozitorit të dhënë vendos një vepër të tij:
a) Wolfgang Amadeus Moxart _____
b) Antonio Vivaldi _____
c) Jozef Hajden _____
d) Franc Shubert _____
- 39.** Plotëso vendet bosh: *Romantizmi* është një drejtim artistik që mbizotëroi në Europë gjatë shekullit _____. Përfaqësuesit e muzikës vokale gjatë kësaj periudhe janë:
- 40.** Përcakto disa nga tiparet kryesore të romantizmit në muzikë:
- 41.** Rendit të paktën katër opera të kompozitorit italian Xhuzepe Verdi.

ARSIMI PROFESIONAL

PËR DOKUMENTACIONIN

- 1.** Qarko shkronjën përbri alternativës së saktë.
Plani vjetor shkollës miratohet nga:
A) Kryetari i bashkisë ose komunës.
B) Këshilli i prindërve.
C) Bordi i shkollës.
D) Ekipi kurrikular i shkollës.

- 2.** Qarko shkronjën përbri alternativës së saktë.
Masa disiplinore “Paralajmërim për përjashtim nga shkolla për thyerje të disiplinës” merret nga:
A) Mësuesi kujdestar.
B) Drejtori i shkollës dhe mësuesi kujdestar..
C) Këshilli i disiplinës.
D) Drejtori i shkollës me pëlqimin e jo më pak se 2/3 e Këshillit të disiplinës.

- 3.** Qarko shkronjën përbri alternativës së saktë.
Bordi i shkollës ka në përbërjen e tij:
A) Vetëm një nëndrejtor të shkollës.
B) Të gjithë nëndrejtorët e shkollës.
C) Vetëm një mësues.
D) Të paktën një mësues.

- 4.** Qarko shkronjën përbri alternativës së saktë.
Ngarkesa mësimore për mësuesit e shkollave publike përcaktohet me udhëzim të veçantë të:
A) Drejtorisë së shkollës
B) Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
C) Këshillit të Ministrave.
D) Drejtorive Arsimore Rajonale

PËR DOKUMENTACIONIN E MËSUESIT

5. Renditni 3 dokumente kurrikulare që përshkruajnë përmbajtjen e lëndës.
6. Duke përzgjedhur një temë nga lënda juaj, planifikoni në formën e një ditari një orë mësimi duke respektuar hapat dhe kriteret që mbahen parasysh.

ASPEKTE TË DIDAKTIKËS NË ARSIMIN PROFESIONAL

7. Qarko shkronjën përbri alternativës së saktë. Testit i rritet besueshmëria kur:
 - A) Zbatohen kritere të ndryshme vlerësimi për nxënësit që i nënshtrohen të njëjtit testim.
 - B) Numri i çështjeve të trajtuara në test është i ulët.
 - C) Sigurohen të njëjtat kushte testimi për nxënësit gjatë testimit.
 - D) Ribëhet testi me të njëjtat pyetje.
8. Qarko shkronjën përbri alternativës së saktë.
 - A) Komunikimi me gjeste transmeton më shumë informacion se sa ai me fjalë.
 - B) Komunikimi efektiv përfshin më shumë se një kanal.
 - C) Komunikimi me gjeste transmeton më shumë informacion se sa ai vizual.
 - D) Komunikimi mediatik përdoret vetëm në praktikat profesionale.
9. Qarko shkronjën përbri alternativës së saktë.

Vlerësimi i nxënësit me testim me shkrim përdoret për vlerësimin e:

 - A) Produktit të punës
 - B) Procedurës së punës.
 - C) Njohurive.
 - D) Shprehive praktike.
10. Në vijat përpara çdo fjalie shkruani gërmën V nëse pohimi është i vërtetë dhe gërmën G nëse pohimi është i gabuar:
 1. Orët e lira përdoren për përforcim të lëndës.
 2. Planifikimi i realizimit të orëve të lira bëhet nga bordi i shkollës.
 3. Orët e lira zënë 10% - 15% të programit lëndor.
 4. Orët e lira mund të mos shënohen në regjistër.

11. Në vijat përpara çdo fjalie shkruani gërmën V nëse pohimi është i vërtetë dhe gërmën G nëse pohimi është i gabuar:

1. Të nxënët nuk ndodh vetëm në klasë.
2. Të nxënët përfshin vetëm atë që është e “saktë”.
3. Të nxënët ndodh vetëm në mënyrë të ndërgjegjshme.
4. Të nxënët përfshin vetëm mësimin e njohurive dhe shprehive.

12. Në vendin bosh në të majtë të numrit shkruani gërmën që i përgjigjet shpjegimi përkatës.

- | | |
|-----------------------------|--|
| 1. Kurrikul | A. Njësi mësimore “autonome” me kohëzgjatje relativisht të shkurtër. |
| 2. Modul | B. Përcakton rezultatet e pritshme të të nxënët. |
| 3. Objektiv mësimor | C. Bën të mundur përcjelljen e informacionit nga burimi te nxënësi. |
| 4. Kompetencë profesionale. | D. Përdoret në një profesion për të përcaktuar në se një detyrë është realizuar në mënyrë të kënaqshme. |
| 5. Medie mësimore | E. Tërësia e planit, programeve, udhëzimeve didaktike, etj. |
| 6. Procedurë | G. Hallkë e sistemit arsimor ku nëpërmjet proceseve mësimore – edukative realizohet kualifikimi për një punësim. |
| 7. Standard profesional | H. Aftësia dhe gatishmëria e një individi për të kryer detyra në një profesion. |
| 8. Arsimit profesional | K. Një seri hapash të lidhur me njëri – tjetrin për të përbushur një detyrë. |

13. Për objektivin:

“Nxënësi të instalojë brenda 2 orësh një lavaman kuzhine, në repartin e shkollës, i cili të mos pikojë dhe të jetë në nivel”, përcaktoni:

Veprimtarinë _____

Objektin _____

Kushtin _____

Standartin _____

14. Rendit 4 hapat kryesore për planifikimin e procesit mësimor teorik.

- 15.** Rendit 5 nga metodat kryesore që përdorni për arritjen e objektivave mësimorë.
- 16.** Shkruaj dy shembuj nga lënda juaj që ilustrojnë zbatimin e dy parimeve didaktike të mëposhtme:
- Lidhja e teorisë me praktikën.
 - Karakteri sistematik dhe gradual i të mësuarit.
- 17.** Shpjegoni arsyet pse duhet të analizohen rezultatet e vlerësimit të nxënësit.
- 18.** Jepni shembull të organizimit, shpërndarjes dhe realizimit të orëve të lira në lëndën tuaj.
- 19.** Shpjegoni si ndikojnë faktorët e mëposhtëm në realizimin e mësimit.
1. Programi mësimor.
 2. Kushtet mësimore.
 3. Teksti mësimor.
- 20.** Harto një njësi testi me katër alternativa duke u mbështetur në përmbajtjen e lëndës tuaj.
- 21.** Harto një “listë kontrolli” për vlerësimin kompleks të nxënësit duke u mbështetur në përmbajtjen e lëndës tuaj.
- 22.** Rendit dhe argumento 3 mënyra të motivimit të nxënësve